

Internews Kosova Politika redaktoriale

** Me shtesën e datës 07.11.2024 sipas vendimit të Kolegjit Redaktorial të Internews Kosova.*

PËRMBAJTJA

Faqet

Rreth organizatës	3 - 4
Misioni i Internews Kosova	3
Vlerat redaktoriale të Internews Kosova	3
Struktura organizative e Internews Kosova	3 - 3
Përmbledhje e Kodit të Sjelljes së I/KS	4 - 5
Gazetaria – Standardi dhe Praktika	6 - 42
Saktësia, balancimi, paanshmëria, mbajtja e të dhënave	6-10
Ankesat, korrigjimet dhe sqarimet	11-12
Temat e ndjeshme dhe materialet ofenduese	13-14
Bashkëpunimi përtej kufijve, procedurat e menaxhimit redaktorial	15-16
Mbulimi i lajmit të fundit/përditësimet	17-18
Të intervistuarit e pambrojtur	19-23
Fotografitë	23-25
Burimet	26-29
Raportimi i fshehtë, zënia pritë dhe gazetaria e atashuar	30-31
Vlerësimet e rrezikut dhe procedurat e sigurisë	31-34
Zgjedhjet	35-36
Citimet	36-38
Media sociale	38-38
Komentet e lexuesve	39-41
Ligji i medias dhe Çështjet Ligjore	42 - 49
Përdorimi i juristëve	42-42
Standardet Ndërkombëtare	42-44
Raportimi i gjykatave – Të miturit dhe proceset mi sulmet seksuale/ përdhunimet	44-47
E drejta e autorit, mbrojtja e të dhënave, privatësia	47-48
Nisja ose përballja e veprimeve ligjore	48-49

Rreth organizatës

Misioni i Internews Kosova (I/KS): të mbështesë shoqërinë civile dhe zhvillimin e mediave të pavarura dhe profesionale në Kosovë dhe të kontribuojë në proceset demokratike të vendit.

Si një organizatë e pavarur jo-qeveritare, misioni i Internews Kosova është të mbështesë shoqërinë civile dhe zhvillimin e mediave të pavarura dhe profesionale në Kosovë e cila mund të kontribuojë në proceset demokratike të vendit. Duke vepruar kështu, I/KS synon të forcojë transparencën dhe përgjegjshmërinë e qeverisjes qendrore dhe lokale përmes gazetarisë hulumtuese dhe verifikimit të fakteve, deri sa stimulon përfshirjen e qytetarëve në vendimarrje në komunitetet lokale. Si pjesë e konsorciumeve regjionale dhe ndërkombëtare, I/KS synon të ndajë vizionin e saj në nivel regjional dhe më gjerë.

Vizioni: Internews Kosova aspiron të shohë njerëzit e Kosovës mjaftueshëm të fuqizuar për t'i njohur të drejtat e tyre përmes ofrimit të informacionit të paanshëm dhe të saktë dhe duke u ofruar hapësirë për tu bërë pjesë e proceseve demokratike. Internews Kosova mëton që të kontribuojë në arritjen e këtij vizioni përmes fuqizimit të mediave dhe shoqërisë civile për të shërbyer si katalizatorë të raportimit hulumtues, verifikimit të fakteve, hulumtimeve të thella dhe veprimeve në terren që kontribuojnë në transicionin demokratik të vendit.

Vlerat Redaktoriale të Internews Kosova

I/KS zotohet të sigurojë raportim të balancuar, të ndershëm, etik dhe të saktë të standardeve më të larta si shërbim ndaj interesit publik. I/KS është plotësisht e pavarur dhe garanton raportim me integritet, paanshmëri dhe ndershmëri nga i gjithë ekipi. I/KS është tërësisht i dedikuar për t'i shërbyer interesit publik dhe raportimit të artikullit/reportazhës me interes publik, pa dëmtuar audiencën përmes trajtimit të pamatur të çështjeve të ndjeshme. E ndërsa i përmbahet standardeve më të larta redaktoriale, I/KS është gjithashtu i angazhuar për të qenë vetë përgjegjës dhe transparent si dhe të njohë gabimet – nëse ndodhin dhe në momentin që ato ndodhin.

Strategic Partnerships

Që nga dita e parë pas themelimit të saj, I/KS ka mëtuar të ndërtojë dhe zhvillojë bashkëpunimin me organizata me natyrë, vlera dhe interesa të ngjashme me I/KS. Ky partneritet është synuar dhe vazhdon të punohet drejt zhvillimit të tij në nivel lokal, regjional e ndërkombëtar.

Anëtarësia në rrjete e shoqata profesionale (lokale, regjionale dhe ndërkombëtare) me qëllim të përmirësimit të punës, përkrahjes së qëllimeve dhe mbrojtjes së interesave të I/KS vazhdon të jetë një synim i rëndësishëm i organizatës.

KALLXO.com ka qenë subjekt i një hulumtimi të realizuar në Kosovë për matjen e perceptimit të qytetarëve të Kosovës në atë se kujt i besojnë më së shumti për të luftuar korrupsionin, e që ka treguar se KALLXO.com është institucioni i dytë më i besuar, vetëm pas Policisë së Kosovës, rezultat ky i konfirmuar gjatë hulumtimit për disa vite me radhë. Të njëjtat parime dhe rregulla të angazhimit e sjelljes duhet të zbatohen edhe për partnerët që angazhohen në prodhim dhe projekte të përbashkëta me I/KS.

KODI I SJELLJES

Vlerat themelore të I/KS konsistojnë në respektimin e standardeve më të larta etike dhe të transparencës të përcaktuara në kodin e saj të etikës duke siguruar mbikëqyrjen e nevojshme nga Kuvendi, partnerët e saj implementues, donatorët dhe partnerët financiarë e kompanitë e jashtme të certifikuara përmes auditimit dhe performancës financiare dhe auditimeve ndërkombëtare të verifikimit të fakteve.

Transparenca, Integriteti dhe Llogaridhënia – I/KS është e përkushtuar të jetë e hapur, e ndershme dhe e përgjegjshme në marrëdhëniet me publikun dhe partnerët. I/KS promovon mundësi dhe vlera të barabarta për të gjithë, duke promovuar integritetin e brendshëm dhe të jashtëm dhe duke bashkëpunuar me partnerë që ndajnë vlera dhe attribute të ngjashme. I/KS kërkon zbatimin e rregullave të sjelljes dhe përgjegjshmërisë nga stafi i organizatës dhe partnerët zbatues të saj.

Pavarësia – Të gjitha aktivitetet e I/KS duke përfshirë produksionin mediatik janë të pavarura politikisht dhe të pandikuara në çfarëdo mënyre nga politika dhe financuesit potencialë siç janë kompanitë private, bizneset, donatorët apo forma tjera.

Barazia – I/KS i trajton të gjithë të punësuarit, partnerët dhe çfarëdo pale në mënyrë të barabartë, pa diskriminim apo krahasime dhe favore për shkak të racës, gjinisë, sfondit kulturor apo etnik. Organizata promovon dhe fuqizon të drejtat e njeriut me qëllim që të ofrojë hapësirë për të gjitha grupet e marginalizuara dhe individët në shoqërinë kosovare.

Të gjithë të punësuarit e I/KS do të pajisjen me kopje të Kodit të Sjelljes dhe atyre u kërkohet të lexojnë dhe të firmosin leximin, kuptimin dhe pajtimin për të ju përmbajtur këtij Kodi. Si gazetarë dhe punonjës të OJQ-ve, stafi duhet të jetë jo-partiak dhe t'u shmanget aktiviteteve-politike apo tregtare të cilat janë ose mund të perceptohen si komprometuese të objektivitetit në mbulimin e lajmeve, përtej aktiviteteve të përshtatshme në avokim.

I gjithë stafi është i obliguar të njoftojë mbikqyrësit e vetë nëse ata janë duke hulumtuar, verifikuar fakte, shkruar apo punuar në çdo lloj apo formë për një organizatë tjetër mediatike, parti politike, kompani private apo organizatë jo-qeveritare.

Të gjithë stafit po ashtu i kërkohet të bëjnë me dije lidhjet-familjare, personale apo të biznesit etj. me kompani apo organizata tjera, nëse janë duke punuar në ndonjë artikull apo projekt që lidhet me këto entitete, e që mund të shihet si konflikt interesi. Kërkohet gjithashtu zbulimi i interesave tregtare apo i konflikteve të mundshme të interesit, në mënyrë që I/KS të mos blejë shërbime ose të mira materiale nga bizneset në pronësi të të afërmeve të punonjësve të vet.

I gjithë stafi duhet të deklarojnë të gjitha aksionet apo interesat e tjera financiare në formë të shkruar te drejtori ekzekutiv. Nëse anëtarët e rrethit të ngushtë familjar të punonjësve të organizatës kanë interesa financiare në produkte, shërbime apo investime që lidhen me organizatën, ata duhet t'i deklarojnë ato menjëherë dhe t'i kërkojnë redaktorit ose drejtorit që hulumtimet, storjet për verifikim të fakteve apo storje të tjera rreth tyre ose të lidhura me to t'i caktohen një gazetari tjetër.

Stafi i I/KS nuk do të përkrahë apo këshillojë publikun për të votuar për asnjë parti politike apo kandidat për ndonjë pozitë zyrtare.

Përveç kësaj, punonjësve të ardhshëm u kërkohet të deklarojnë në formë të shkruar aktivitetet politike të tanishme ose të shkuara, dhe çfarë do përfshirje në fushatat partiake apo çfarëdo forme tjetër e përkrahjes apo financimit të partive politike përpara përfshirjes në organizatë.

Anëtarësimi jo-aktiv në parti politike apo aktivitete të mëparshme politike nuk përbëjnë pengesë për punësim. Megjithatë, kërkohet deklarimi i veprimtarive politike të tanishme dhe të shkuara, në mënyrë që drejtori të kenë mundësinë të marrë vendime të informuara mbi trajtimin e artikujve dhe projekteve ku individët kanë lidhje të ngushta me parti të veçanta dhe/ose ku ka shqetësime të ligjshme mbi perceptime të mundshme të anshmërisë.

I/KS nuk do të punësojë askënd që mban një pozitë të paguar apo prominente në parti politike, qeveri, kompani publike apo shtetërore e që janë nën kontrollën direkte të partive politike apo të qeverisë.

Gazetarët nuk mund të pranojnë dhurata të asnjë forme apo përfitime për veten, anëtarët e familjes ose bashkëpunëtorët e ngushtë nga kompanitë apo individët me të cilët ata mund të kenë marrëdhënie në emër të I/KS. Përfitimet e papranueshme personale përfshijnë por nuk kufizohen vetëm në: hua, para, mallëra, shërbime, ulje çmimesh dhe argëtim jashtë kufijve të mikpritjes së zakonshme profesionale. Hollësitë e mëtejshme mund t'i gjeni në Politikën Anti-Korrupsion të I/KS. Nëse kanë ndonjë dyshim, punonjësit duhet të kërkojnë miratimin e drejtorit.

Përkrahja e interesit publik pa paragjykim- Stafi i I/KS pritet të pasqyrojë shumëllojshmërinë e pikëpamjeve dhe interesave, pa promovuar apo theksuar në mënyrë të padrejtë këndvështrime të veçanta. Raportimi duhet të jetë i balancuar, pa asnjë lloj paragjykimi sa i përket moshës, etnisë, gjinisë, orientimit seksual, statusit veteran, qëndrimeve politike, etj.. Mbulimi duhet t'u japë peshën e duhur pikëpamjeve të ndryshme. Stafi i I/KS duhet të promovojë ndërgjegjësimin publik dhe të edukojë lexuesit e larmishëm mbi të drejtat dhe përgjegjësitë.

Profesionalizmi- Pritet që i gjithë stafi të sillet në mënyrë profesionale në të gjitha marrëdhëniet e tyre me kontakte të brendshme dhe të jashtme, duke përfshirë pranimin e rregullave organizative dhe respektimin e linjës menaxhuese dhe linjës së raportimit.

GAZETARIA-STANDARDI DHE PRAKTIKA

SAKTËSIA, BALANCIMI, PAANSHMËRIA, MBAJTJA E TË DHËNAVE

Saktësia

I/KS përkushtohet të prodhojë informacione të sakta dhe të besueshme në të gjitha produktet e veta. Ndërsa shpejtësia është gjithnjë e rëndësishme për çdo organizatë që merret me verifikim të fakteve dhe lajme, I/KS e konsideron se të raportuarit i pari por gabim është ë më keq se sa të jetë lajmi pak i vonuar- për t'u siguruar që faktet janë të sakta.

***“Është me rëndësi të jemi të parët,
por është shumë më me rëndësi të jemi të fundit që raportojmë”!***

Gazetarëve u kërkohet të jenë transparentë në lidhje me burimet e informacionit duke përfshirë vetëm përdorimin e ekspertëve të mirëfilltë dhe prezantimin korrekt të dokumenteve si dhe atribuirimin e statistikave me lidhjet përkatëse në internet kur dhe ku është e mundur. Kredencialet e të intervistuarve-profesioni, autorësia në raporte përkatëse, etj. si dhe vendi i punës duhet të citohen qartë në të gjithë artikujt/reportazhet, në mënyrë që audiencia të ketë mundësinë të gjykojë vet për nivelin e tyre të ekspertizës. *Shih udhëzimin mbi përdorimin e burimeve anonime.*

Për të shmangur mashtrimet, gazetarët, verifikuesit e fakteve, zyrtarët ligjor, hulumtuesit, monitoruesit dhe redaktorët duhet të marrin në konsideratë nëse duhet të kryejnë kontrollë shtesë mbi kualifikimin e kontribuuesve të rinj/ të intervistuarve për t'u siguruar se ata janë vërtetë ashtu si pretendojnë. Këto kontrole mund të përfshijnë verifikime të thjeshta me ekspertë të tjerë të besueshëm apo kontribuues të rregullt, të cilët do të duhej të njihnin kontribuuesin në fjalë.

Ndërsa saktësia dhe kontrolli i fakteve janë kryesisht përgjegjësi individuale e gazetarëve, drejtorët dhe redaktorët duhet të pyesin gazetarët mbi kontribuuesit e rinj, të cilët ofrojnë komente ose deklarata veçanërisht sensacionale apo kundërthënëse dhe kini parasysh se verifikimet në internet nuk janë gjithmonë të mjaftueshme- si ishte rasti i BBC/i intervistës lajthitëse mbi shpërthimin e impiantit kimik Bhopal, e cila u transmetua pasi një gazetar-mesa duket- u mbështet në verifikimin e kredencialeve të autorit të rrengut përmes faqes online të kompanisë së kimikateve. Faqja online ishte hakuar, ndërkohë që pretendimet e personit se kompania kishte rënë dakord të paguante kompensimin rezultuan të rreme.

Gjithashtu, përdorimi i faqeve si Wikipedia nuk është i mjaftueshëm për kontrole të sakta. Gazetarët duhet t'u referohen burimeve parësore. Artikujt e publikuar gjatë kohëve të fundit nga I/KS duhet të konsultohen, por ato duhet të përdoren me kujdes dhe pas kontroleve të dyfishta. Gazetarët pritet të lajmërojnë redaktorin e tyre nëse gjejnë gabime të çfarëdo lloji në artikuj/reportazhe të arkivuara.

Gazetarët e I/KS duhet gjithashtu të vlerësojnë rëndësinë e kontributeve dhe të masin nëse këto publikime janë vërtetë në interes të publikut. Nëse ka shenja të qarta se kontribuuesi i mundshëm ka “mprehur sëpatën” apo është i nxitur nga motive të tjera, të cilat tregojnë se ai thjesht po kërkon që I/KS të publikojë artikuj/reportazhe të dëmshme dhe me vlera të vogla për interesin publik, gazetari apo redaktori/drejtori duhet të marrë në konsideratë kryerjen e kontroleve shtesë për të vërtetuar informacionin-përfshirë kontrollin e kryqëzuar të dokumentacionit- (duke vonuar kështu publikimin) ose madje duke vendosur të mos e publikojë atë.

Xhirimet, pretendimet dhe materialet e shpërndara në internet përmes llogarive në media sociale, duhen gjithashtu t'u nënshtrohen verifikimeve dhe jo thjesht të merren si vlerë nominale. Pjesën më të madhe të kohës kjo do të përfshijë verifikimin nëse llogaria i përket vërtet personit në fjalë, kontrollin e fakteve, gjurmimin dhe kontaktimin e burimit parësor. Qendra Europiane e Gazetarisë ka publikuar një numër udhëzuesish të dobishëm online në disa gjuhë për verifikimin e përmbajtjes dixhitale: <http://verificationhandbook.com/>

Gazetarët duhet të jenë të kujdesshëm dhe të disiplinuar për t'iu përmbajtur Udhëzuesit të Stilit të I/KS për drejtshkrimin dhe terminologjinë e preferuar, kur shkruajnë për publikime.

Verifikimi i fakteve

Verifikimi i fakteve është i detyrueshëm për të gjitha hulumtimet. Të gjitha publikimet me verifikim të fakteve duhet të jenë subjekt i një procesi të detajuar që fillon nga gazetari, redaktori, kontrolluesi i fakteve dhe zyra ligjore.

Të gjitha hulumtimet e diskutabile të cilat përfshijnë individë apo organizata të njohura ose me gjasë të prirura për padi gjyqësore, duhet të kontrollohen zyra ligjore dhe redaktorët përgjegjës, të cilët janë përgjegjës për kontrollimin tërësor të fakteve.

Gazetarët/redaktorët që nuk janë përfshirë në prodhimin e artikullit/reportazhës duhet të kryejnë kontrollimin e fakteve. Gazetarët pritet të ruajnë dokumentet, e-mailët, përgjigjet, shënimet, regjistrimet, etj. në një dosje, në mënyrë që të mbështesin menjëherë pretendimet dhe përmbajtjen e artikullit/reportazhës në atë mënyrë që i gjithë hulumtimi dhe raportimi të mund të mbështetet dhe nëse paraqitet nevoja edhe të përsëritet më vonë.

Gazetarët dhe i gjithë stafi duhet të jenë të vetëdijshëm që redaktorët e I/KS rezervojnë të drejtën të kontaktojnë të intervistuarit dhe të verifikojnë citimet, si dhe materialet e tjera.

Hulumtimet shumë të ndjeshme ose veçanërisht të vështira duhet t'i referohen drejtorit ose redaktorëve përgjegjës për kontrole shtesë, para dërgimit për publikim.

“Nuk do të ketë asnjë publikim përveç nëse nuk është miratuar paraprakisht nga së paku tre palë sy në dy momente të ndryshme kohore”!

Për mbulimin e lajmeve të ditës, si lajmet apo raportimet nga gjykatat, gazetari është përgjegjës për të siguruar saktësinë e fakteve dhe gjithashtu prezantimin e ndershëm dhe të balancuar të tyre. Vini re se redaktorët mund të kërkojnë informacione shtesë, përfshirë citime të regjistruara etj. Gjithsesi, redaktori ka përgjegjësinë që të marrë faktet e duhura dhe të dy- gazetari dhe redaktori do të mbahen përgjegjës, nëse dështojnë ta bëjnë këtë.

Gazetarët që raportojnë nga gjykatat, ku çdo formë e procesit të regjistrimit është e ndaluar duhet të këshillohen me redaktorin më të lartë se si të sigurohen që citimet nga gjykata të jenë 100 për qind të sakta, veçanërisht kur ata nuk kanë aftësinë e të shkruarit shpejt.

I/KS pret që gazetarët të dinë nëse ata mund të kërkojnë leje nga gjykatat për të regjistruar me qëllimin e mbajtjes së të dhënave të sakta (të cilat nuk janë për publikim) dhe të konsultohen me redaktorin përgjegjës ose drejtorin në rastet kur duhet vepruar kështu.

Nëse punojnë për hulumtime të bazuara në procese gjyqësore, gazetarët e I/KS duhet të kërkojnë transkriptet zyrtare të gjykatës për të siguruar saktësinë, aty ku ato janë në dispozicion në varësi të ligjeve lokale.

Gazetarët janë përgjegjës për të siguruar saktësinë e lajmit të fundit, përfshirë edhe njohjen e organizatës mediatike që e publikoi për herë të parë atë. Gazetarët pritet që të ngrenë çdo dyshim ose shqetësim të redaktori në detyrë, të cilit mund t'i kërkohet gjithashtu të ndihmojë në procesin e raportimit me shpejtësi dhe saktësi.

Nëse artikulli është publikuar fillimisht nga një media tjetër, raportimet e para të publikuara nga I/KS duhet të theksojnë se ngjarja ndodhi sipas agjencisë/medias dhe ta atribuojë atë saktë. Për shembull: Një avion pasagjerësh besohet të ketë humbur 20 minuta pasi u largua nga Prishtina, sipas agjencisë së lajmeve XYZ.

I/KS pret nga të gjithë gazetarët që të atribuojnë të gjitha burimet me saktësi. Gazetarët duhet të punojnë shumë shpejt për të vërtetuar faktet në mënyrë të pavarur, pasi të publikojnë artikuj/reportazhe fillestare që i japin kredite një agjencie apo një medije tjetër. Një raport i ri i prodhuar nga I/KS duhet të publikohet sa më parë që të jetë e mundur.

Publikimet e I/KS do të ruajnë sigurinë e individëve që janë subjekt i publikimeve të tij, në mënyrë që të shmangët ekspozimi i identitetit të autorëve dhe shpërndarësve të përmbajtjes dezinformuese për të evituar çfarëdo reperkusioni të panevojshëm publik. Kjo vlen veçanërisht për individët/personat privatë që nuk mbajnë funksion publik, nuk janë anëtarë të ndonjë partie politike, nuk janë anëtarë ose të lidhur me ndonjë grup interesi apo nuk ushtrojnë ndikim publik.¹

Balancimi redaktorial dhe paanshmëria

I/KS bën gazetari të përgjegjshme dhe i përkushtohet parimeve të gazetarisë së pavarur dhe etike. Ndërsa I/KS nuk mundet të përfshijë çdo këndvështrim të mundshëm në çdo artikull/reportazh, gazetarët pritet të sigurojnë mbulimin e të gjitha anëve të përshtatshme të artikullit/reportazhës dhe duhet të pasqyrojnë në mënyrë të arsyeshme një sërë mendimesh dhe pikëpamjesh-dhe t'u jepet pesha e duhur pikëpamjeve të ndryshme.

Paanshmëria është çelësi i reputacionit të I/KS si një media e besueshme dhe balancimi i duhur është kërkesë absolute, pavarësisht opinioneve të redaktorit/gazetarit, të cilat nuk duhet të shprehen fare në mbulimin e lajmeve. Nëse të intervistuarit apo kontribuuesit janë të lidhur me parti politike, pikëpamje apo forma tjera të interesit personal kjo duhet gjithashtu të bëhet e qartë në të gjitha materialet e publikuara/transmetuara.

Në shkrime duhet të jepet informacioni i tërësishëm për pozicionin e plotë të punës dhe punëdhënësin si dhe çdo informacion tjetër i përshtatshëm, si për shembull nëse ka qenë kontribues për një parti të caktuar- të gjitha këto duhet të jenë të shkruara në tekst. Për materialet televizive, redaktorët duhet të vendosin nëse do ta shkruajnë këtë informacion në skenar ose ta prezantojnë atë përmes titrave.

Gazetarëve u kërkohet ndonjëherë të shkruajnë komente, skica politike dhe recensione, por ata duhet ta kufizojnë shprehjen e opinioneve në ato të një vëzhguesi ekspert dhe duhet të sigurohen që të mos shkruajnë apo publikojnë opinione, të cilat mund të komprometojnë perceptimin mbi integritetin e tyre si gazetar (pjesë të tilla, të cilat janë ose mund të interpretohen lehtësisht si të njëanshme në favor të një partie politike të caktuar).

Një shembull tjetër mund të përbëjë shkrimi i komentit mbi kushtet ekonomike. Një gazetar mund të komentojë mbi kushtet mbizotëruese, dështimet në zbatim/menaxhim në nivel politik të qeverisjes lokale apo të politikave të përgjithshme ekonomike, por ai nuk mund të përfshihet thjesht në sulme ndaj një partie politike për të mbështetur një ose disa parti të tjera.

¹ Ky paragraf është shtuar me 07.11.2024 sipas vendimit të Kolegjit Redaktorial të Internews Kosova.

Sërish një tjetër shembull mund të jetë një koment mbi një projekt të diskutueshëm. Një gazetar mund të komentojë mbi mungesën e dukshme të transparencës, kundërshtimit të publikut apo përfitimet/disavantazhet e mundshme. Sidoqoftë, gazetari nuk mund të avokojë për llogari të një kompanie të veçantë ose të dështojë të mbulojë në mënyrën e duhur spektrin e opinionit publik –dhe nuk duhet të sulmojë një zhvillues vetëm për hir të sulmit.

Shumë shpesh, këto shkrime duhet gjithashtu të përfshijnë një sërë ekspertësh- kritikësh të jashtëm. Gazetarët duhet ta pyesin veten nëse ata janë vërtetë më të mirët për të komentuar ose të marrin në konsideratë faktin se kontraktimi i një eksperti të jashtëm për të komentuar mbi çështjen mund të ishte më i përshtatshëm.

Komentet nuk duhet të promovojnë kompani apo produkte të veçanta, ndonëse recensionet mund të vlerësojnë në mënyrë të ndershme meritat apo dobësitë e produkteve, restoranteve, argëtimeve, etj..

Gazetarëve u kërkohet gjithashtu të zbulojnë çdo konflikt të mundshëm interesi personal, tregtar apo politik etj. siç vihet në dukje në përmbledhjen e Kodit të Sjelljes. Drejtojuni Kodit të Sjelljes për udhëzimin e plotë në deklarimin e interesave personale.

Ndershmëria, drejtësia, e drejta e përgjigjes

Gazetarët e I/KSt duhet t'i prezantojnë të intervistuarit, kontribuuesit, ekspertët etj., në mënyrë të saktë dhe jo t'i përshkruajnë ata thjesht si ekspertë të një fushe të caktuar, por të sigurohen në dhënien e saktë të titullit, kredencialeve dhe të vendit të punës. Gazetarëve nuk u kërkohet vetëm të zbulojnë pozicionin e punës së të intervistuarit, afërsitë e tij, vendin e punës, nivelin dhe fushën e ekspertizës, por duhet gjithashtu të paraqesin në mënyrë të saktë se çfarë thanë ata saktësisht në lidhje me secilën çështje dhe linjë të pyetjeve. Gazetarët nuk duhet asnjëherë të nxjerrin kontributet apo citimet nga konteksti. Ato duhet të përdoren gjithmonë në mënyrë të drejtë dhe të ndershme brenda kontekstit të intervistës.

Të gjithë kontribuuesit duhet të informohen plotësisht mbi mënyrën se si materialet e tyre, fotot, raportet, statistikat, citimet etj. do të përdoren, ndërsa gazetarët duhet ta bëjnë të qartë nëse ato do të shërbejnë për lajm, analizë, reportazh apo hulumtim dhe të shpjegojnë temën në përgjithësi. Pa këtë lloj transparence, nuk mund të thuhet që të intervistuarit apo kontribuuesit kanë dhënë pëlqimin e tyre të informuar mbi intervistën, etj..

Gazetarët duhet t'u sigurojnë individëve, organizatave apo kompanive të përmendura në artikull/kronikë mundësinë e drejtë për t'u përgjigjur kritikave apo akuzave, duke përfshirë rastet kur kritikën nuk lidhen në mënyrë specifike me veprime të paligjshme. Kur prezantohen pretendime ose fakte, ata mund të ofrojnë korrigjime ose sqarime të cilat duhet të përfshihen në mënyrë të ndershme dhe të rregullt. Atyre u duhet dhënë informacion i mjaftueshëm mbi çështjet/prendimet, në mënyrë që të jenë të aftë të japin përgjigje të informuara. Kjo bëhet për të siguruar drejtësi dhe balancë dhe zakonisht njihet si "e drejta për tu përgjigjur".

Gazetarët dhe redaktorët duhet të shohin për çdo person, organizatë apo kompani të përmendur në përmbajtjen e një artikulli dhe të pyesin veten nëse u duhet dhënë e drejta për t'u përgjigjur. Nëse konsiderohet se është e nevojshme, këtyre entiteteve u duhet dhënë një kohë e arsyeshme për t'u përgjigjur. Drejtësia është një ndër parimet kyçe të I/KS ndaj kompanive/njerëzve të prezantuar në përmbajtje nën një dritë negative ose të akuzuar për vepra të këqija, prandaj duhet t'u jepet e drejta e përgjigjes. Nëse një individ, organizatë apo kompani refuzon të përgjigjet, artikulli/reportazha duhet të përmbajë një rresht ku theksohet se atyre u është dhënë mundësia për t'u përgjigjur akuzave të bëra/çështjeve të ngritura në artikull/reportazh, por nuk u përgjigjen ose haptazi nuk pranuan të komentonin.

Çdo përjashtim nga ky rregull duhet të vlerësohet rast pas rasti dhe të miratohet nga drejtori i vendit apo redaktori përgjegjës para publikimit/transmetimit.

Mbajtja e të dhënave

I/KS promovon ruajtjen e të dhënave mbi monitorimin, hulumtimin dhe procesimin e raporteve duke përdorur kallxOS (Kallxo Operating System – Kallxo Sistemi Operativ), që është një zgjidhje softuerike, aplikacion dhe databazë për të ruajtur jo vetëm informacionet dhe raportet fillestare, por edhe tërë procesin e trajtimit të informacionit dhe/ose trajtimit të rasteve brenda strukturës redaktoriale dhe proceseve publikuese. I gjithë ky informacion dhe procesimi i tij do të konsiderohet si konfidencial dhe subjekt i Marrëveshjeve të Konfidencialitetit në mes të organizatës dhe çdo personi të punësuar.

Gazetarëve dhe stafit të I/KS u kërkohet që të ruajnë të dhënat për një periudhë minimumi tre vjeçare, duke përfshirë blloqet e shënimeve, regjistrimet, dokumentet dhe informacione të tjera. Kjo vlen për tërë stafin, gazetarët dhe stafin teknik dhe përfshin raportimin e lajmeve të ditës, reportazhet, verifikimin e fakteve dhe hulumtimet. Nëse një artikull/reportazh/temë është ripublikuar në një datë të mëvonshme, redaktori përgjegjës dhe/ose drejtori duhet të sigurohen që të instruktojnë gazetarin që t'i ruajë të dhënat për një periudhë më të gjatë.

Gazetarët duhet të sigurohen që të gjitha shënimet të jenë të datuara dhe shenjëzuar saktësisht - kjo përfshin edhe blloqet e shënimeve, të cilat duhet që në mbështjellësin e jashtëm të kenë emrin e tyre dhe datat që mbulojnë. Me fillimin e çdo dite pune, gazetarët duhet të shënojnë datën mbi faqen e caktuar. Shënimet e çdo interviste apo telefonate duhet të kryesohen nga emri dhe nëse është e nevojshme, adresa/vendndodhja, profesioni dhe pozicioni i punës si dhe numri i telefonit të çdo personi me të cilin është folur në lidhje me artikull/reportazh.

Me të mbaruar, gazetari do të tërheqë një vijë në fund të shënimeve të atij rasti dhe nuk do të modifikojë shënimet pasi t'i ketë shkruar ato, sepse ankuesit mund të pretendojnë se janë ndryshuar ose futur materiale të tjera për të mbështetur artikullin/reportazhin. Gazetarët duhet të regjistrojnë, ose të mbajnë shënime në formë të emailit, në formë të shkruar ose audio/video të çdo përpjekjeje për të marrë përgjigje për pretendimet ose akuzat e përfshira në çdo artikull/reportazh/temë. Për disa produkte, si për shembull raportet e proceseve mbi krimet e luftës, I/KS ka vendosur që të mbajë arkivë të përhershme ose afatgjatë. Gazetarët duhet, si pasojë, të verifikojnë me drejtorin përpara se të shkatërrojnë të dhëna, edhe nëse kanë kaluar tre vite që nga publikimi/transmetimi i fundit.

Nëse gazetarët largohen në një organizatë tjetër, ata duhet të dorëzojnë tërë arkivën e tyre në formë elektronike, në letër, blloqet e shënimeve, emailat, audio/video, etj., te zyra për Burime Njerëzore, te redaktori i tyre përgjegjës apo te drejtori. Për artikullin/reportazhin i cili është subjekt i ankesave ose veprimeve ligjore, stafit i kërkohet të ndihmojnë në çdo hetim të mëvonshëm I/KS për saktësimin e fakteve etj., në raportet e tyre, edhe nëse ata janë larguar nga I/KS. Vini re që çdo publikim-madje nga e njëjta organizatë, mund të trajtohet si një pretendim i ri/i veçantë në veprim. I/KS ruan të drejtën që të kontrollojë të gjitha të dhënat- duke përfshirë shënimet dhe përkthimet e gazetarëve në çdo kohë, para dhe pas publikimeve/transmetimeve.

Për stafin jashtë I/KS -_si kontribuues të pavarur/të jashtëm, pjesëmarrësit apo anëtarët e bursave të ndryshme etj., të dhënat duhet të rishikohen nga redaktori përgjegjës dhe një përzgjedhje e tyre duhet të ruhet nga menaxheri i caktuar i programit ose drejtori për një periudhë minimumi tre vjeçare. Stafit i I/KS pritet që t'i ruajë të dhënat e veta, por drejtori dhe menaxherët e programeve do të mbahen përgjegjës për ruajtjen e të dhënave për artikull/reportazh me ndjeshmëri dhe për të gjitha hulumtimet. Pa mbajtjen në mënyrë të duhur të të dhënave, I/KS nuk do të jetë në gjendje që të kundërshtojë ankesat apo kërkesat për kompensim pas publikimit/transmetimit.

ANKESAT, KORRIGJIMET DHE SQARIMET

Ankesat dhe korrigjimet

Nëse gjendet se I/KS ka publikuar informacion të pasaktë, të padrejtë ose edhe të fabrikuar - kjo do të trajtohet si shkelje e rëndë e politikës dhe e parimeve redaktoriale. Raste ekstreme, të tilla ku zbulohet se një gazetar ka fabrikuar ose ka ndryshuar qëllimisht citimet, etj. do të trajtohet si arsye për veprime disiplinore, përfshirë edhe shkarkim të mundshëm apo masa të tjera ligjore.

Falsifikimet dhe artikujt/reportazhet që keqprezantojnë individë apo organizata shkatërrojnë jetë dhe reputacione!

Kreredaktori i I/KS dhe/ose redaktorët përkatës do të jenë përgjegjës për të vlerësuar nëse ankesat janë të vlefshme apo jo dhe t'i referojnë te drejtori. Nëse një ankesë rezulton të jetë e pabazë dhe rrjedhimisht e pavlefshme, drejtori dhe kryeredaktori duhet të vendosin nëse do të botojnë kundërshtim i cili deklaron se pas një hetimi të brendshëm është arritur në përfundimin se faktet janë të sakta dhe se ata i qëndrojnë pas publikimit.

Çdo ankesë që konsiderohet si e vlefshme do të publikohet në rubrikën Letër Redaksisë, së bashku me përgjigjen e duhur të organizatës. I/KS ruan të drejtën të mos publikojë gjuhë të papërshtatshme, gjuhë të urrejtjes dhe deklarata që shkelin standardet e kodit etik.

Si në rastet kur ankesa konsiderohet e vlefshme, ashtu edhe në rastet kur konsiderohet e pavlefshme, drejtori, kryeredaktori apo redaktori i caktuar janë përgjegjës për mbajtjen e shënimeve mbi mënyrën se si është trajtuar dhe hetuar ankesa, pasi atyre mund t'u duhet ta prodhojnë atë në një datë të mëvonshme. Për më shumë detaje, shiko seksionet e mëposhtme: Procedurat standarde të menaxhimit të ankesave dhe Menaxhimi i Krizave për artikujt e diskutueshëm.

I/KS do t'i korrigojë gabimet menjëherë. Në rastin e gabimeve serioze, keqprezantimeve dhe/ose falsifikimeve, drejtori do të marrë në konsideratë nëse duhet të publikojë një artikull/reportazh të veçantë për të korrigjuar të parën me të njëjtën rëndësi - si faqja e pare - nëse konsiderohet gabim aq i rëndësishëm sa ta justifikojë këtë. Në disa raste, redaktori ose drejtori mund të heqin plotësisht një artikull/reportazh nga faqja e internetit, deri në përfundimin e një hetimi të brendshëm.

Çdo publikim i I/KS-it do të përfshijë një faqe për Ankesa dhe, ku do të publikohen ankesat dhe korrigjimet kryesore. Këto faqe do të përmbajnë gjithashtu përmbledhjen e ankesave të paraqitura dhe rezultatin e vlerësimit të I/KS, duke përfshirë këtu edhe ankesat që nuk janë pranuar, pasi I/KS ka vendosur që raportet kanë qenë të sakta e të drejta.

Procedurat standarde të menaxhimit të ankesave

Gazetarët nuk duhet asnjëherë që të kërkojnë falje në emër të I/KS, pasi mund të ketë implikime ligjore. Staf i ri dhe korrespondentët duhet të mbajnë shënim ankesat dhe t'ia referojnë menjëherë ato redaktorit përkatës (në detyrë apo përgjegjës), duke i shpjeguar pretenduesit se dikush nga I/KS do ta kontaktojë rreth çështjes, sa më parë që të jetë e mundur. Redaktori duhet më pas që të vendosë nëse do t'ia referojë ankesën drejtuesve menaxherialë apo do ta trajtojë vetë atë, në mënyrë të drejtpërdrejtë. Ankesat nga përfaqësuesit ligjorë duhet të referohen automatikisht te drejtori ose kryeredaktori.

Gazetarët mundën gjithashtu t'i sugjerojnë ankuesve - vetëm kur ankesa nuk është shumë serioze apo ka të bëjë në të vërtetë me shprehjen e pakënaqësisë mbi mbulimin e çështjes në përgjithësi - që t'i shkruajnë redaktorit përmes faqes së internetit si dhe t'i shpjegojnë se letra do të publikohet.

Korrigjimet e vogla - gramatike, drejtshkrimore apo të shqiptimit - duhet të bëhen menjëherë. Gabimet më të mëdha - si pasaktësi të rënda të fakteve - duhet të korrigjohen nga redaktori në detyrë, bashkë me një shënim për korrigjimin të bërë në fund të tekstit për storiet online. Redaktori në detyrë mund të vendosë që ta referojë ankesën te redaktori përgjegjës ose drejtori, i cili mund të vendosë që të botojë një sqarim të veçantë në faqen e ankesave dhe korrigjimeve.

Menaxhimi i krizës për artikujt e kontestuar

Deri sa procedurat e identifikimit dhe kontrollit të fakteve duhet të parandalojnë shumicën e situatave të krizës, do të ketë raste, shpresojmë të jenë të rralla, kur I/KS duhet të sigurojë një përgjigje të shpejtë, vendimtare dhe të unifikuar ndaj krizave, duke përfshirë ankesat e rënda për artikull/reportazh të keqprezantuar apo të rreme, të cilat nuk mund të trajtohen brenda procedurave standarde të trajtimit të ankesave.

Drejtori duhet të njoftohet menjëherë dhe ai/ajo duhet të ndjekë “zinxhirin komandues” në këto situata. Një ekip i pavarur do të themelohet për të verifikuar artikullin/reportazhin si dhe do të vendosë mbi hapat e mëtejme, duke përfshirë informimin e mundshëm të donatorëve. Drejtori duhet të përcjellë shënimet e mbajtura, siç përcaktohet në **seksionin e mbajtjes së të dhënave**.

Në rastin e kontestimeve publike mbi artikujt ose paditë e I/KS, I/KS do të publikojë lajme duke informuar publikun se çfarë po ndodh aktualisht, pa paragjykim apo pa ndonjë lloj qëndrimi.

Në rastet kur artikulli/reportazha është e gabuar, organizata I/KS duhet të lëshojë një deklaratë që e pranon atë. Nëse artikull/reportazha qëndron, I/KS duhet të lëshojë një deklaratë, ku thot se gjetjet u vërtetuan përmes një verifikimi të pavarur. Drejtori i I/KS duhet të sigurohet që “mësimet e nxjerra” të ndahen brenda organizatës dhe të bëhen pjesë e procedurave redaktoriale të ankesave apo të politikave të menaxhimit të krizave.

Publikimi i ndjesës ose i tërheqjes

Ashtu si anëtarët e stafit nuk duhet t'u kërkojnë automatikisht falje ankuesve dhe si pasojë, të pranojnë ligjërisht ekzistencën dhe/ose përgjegjësinë për gabime ose pasaktësi para se drejtuesit e lartë të vendosin se si të hetojnë ose të trajtojnë ankesën, drejtori duhet të marrë parasysh pasojat ligjore në rastin e publikimit të kërimit të faljes. Mund të ndodhë që drejtori të këmbëngulë që ankuesi të firmosë një dokument të heqjes dorë për të mbrojtur I/KS nga veprimet e ardhshme ligjore.

McNae sugjeron formulimin e mëposhtëm: Unë konfirmoj që publikimi i një kërkimfaljeje sipas termave bashkangjitur në një pozicion me rëndësi të arsyeshme në numrin e ardhshëm të botimit [emri i publikimit, i programit etj.] do të pranohet plotësisht dhe përfundimisht për çdo pretendim të ardhshëm që unë mund të kem ndaj artikullit/programit/titullit të artikullit të publikuar/transmetuar në [numrin e publikimit/datën etj.].

Drejtori është përgjegjës për të ndjekur procedurat e publikimit të ndjesës dhe të ndonjë lloji të ngjashëm të tërheqjes nga publikimi, nëse janë të kontrolluara për përputhjen me ligjet e Kosovës. Kontrollimi i dokumentit të tërheqjes nga artikulli është jetik, për të mos krijuar pa dashje probleme shtesë nën ligjet e Kosovës.

TEMAT E NDJESHME DHE MATERIALET OFENDUESE

Temat e ndjeshme, materialet sulmuese, imazhet grafike

I/KS është e përkushtuar të prodhojë hulumtime të thella për të siguruar raportimin e lajmeve me interes publik si dhe të mbajë autorët e keqbërjeve dhe pushtetarët përgjegjës. Si e tillë, produktet e I/KS do të mbulojnë rregullisht subjekte dhe do të përfshijnë materiale që janë shumë të ndjeshme. Mbulimi duhet të jetë i kujdesshëm për ndjeshmërinë e zonave post konfliktuozë, nuk duhet të nxisë tensione në mënyrë të papërgjegjshme, nuk duhet të shpërfillë tensionet pas luftërave dhe të mos shfrytëzojë mosmarrëveshjet etnike.

Thënë këtë, I/KS nuk do të shmangë raportimin e subjekteve të ndjeshme apo të kontestuara, por thjesht ndërmerr përsipër ta bëjë këtë me respekt dhe ndjeshmëri të përshtatshme. Gazetarët duhet të sigurojnë që subjektet e prekshme të trajtohen me ndjeshmërinë e duhur dhe të bien dakord që të ruajnë të dhënat ose informacionet që mund të çojnë në identifikimin e disa prej të intervistuarve të pambrojtur, ku përfshihen edhe të mbijetuarit e përdhunimeve. Çdo gjuhë e përdorur apo e promovuar nga gazetarët e I/KS duhet të jetë e respektueshme dhe gjithëpërfshirëse në aspektin e diversitetit etnik, gjinor, të orientimit seksual, të racës, paaftësisë, fesë/besimit, etj..

I/KS identifikon ose thekson racën/përkatësinë etnike, gjininë, orientimin seksual ose fenë, vetëm nëse është e rëndësishme për temën, d.m.th., nëse artikulli/reportazha flet për përkatësinë etnike, racën, gjininë etj. I/KS përdor termin *i zi* dhe jo *me ngjyrë*, përveç rasteve kur artikulli/reportazha ka të bëjë me aparteidin, ku ngjyra ishte kategori zyrtare raciste. Termat *homoseksual* ose *gay/lesbik/ LGBT*-në varësi të kontekstit preferohen më shumë se *një burrë homoseksual* apo *burrat homoseksualë*. Bën përjashtim vetëm kur personi i intervistuar i përdor ato terma dhe I/KS e citon atë në mënyrë të drejtpërdrejtë.

I/KS pret që gazetarët dhe i tërë stafi t'u përmbahen këtyre standardeve gjatë gjithë kohës, duke përfshirë edhe rastet kur postojnë materiale në llogaritë e faqeve të punës, faqeve personale në media sociale, pasi çdo përdorim i termave përçmues apo madje edhe postimi i materialeve që mund të perceptohen si përçmuese mund të ndikojë negativisht në reputacionin e I/KS si një media e drejtë, gjithëpërfshirëse dhe e paanshme.

Si rregull, I/KS nuk përdor terma ofendues, asnjë sharje apo fjalë përçmuese. Përjashtimet e vetme janë sërish kur këto terma përdoren nga të intervistuarit, janë të rëndësishme për artikulli/reportazhën dhe duhet të përdoren në citime të drejtpërdrejta. Një shembull i kësaj mund të ketë qenë përdorimi nga Presidenti Obama i fjalës *zezak*. Kjo është një fjalë shumë fyese, por fakti që presidenti i parë i zi e përdori atë në kontekstin e një interviste mbi racizmin në Shtetet e Bashkuara ishte vetë artikulli/reportazha dhe mund të përdoret në citimin e tij dhe ndoshta edhe në titull. Jashtë një situatë të këtij lloji, ky term nuk duhet përdorur kurrë.

I/KS nuk publikon blasfemi apo mallkime, përveç rasteve ku ato janë fokusi i një artikulli/reportazhe ose të nevojshme për të. Edhe atëherë, redaktorët ruajnë të drejtën që të përdorin asteriks për të shmangur ofendimet e panevojshme. Për shembull: Deputeti u filmua duke i thënë një gazetari se ai ishte “një b***ard i dh***rë gënjeshtar”. Producentët e programeve televizive apo të radios duhet të marrin në konsideratë orarin se kur emisionet e tyre do të transmetohen si dhe faktin nëse ata duhet të vendosin sinjalin “bip” për sharjet apo t'i lejojnë ato, ose të përfshijnë një paralajmërim paraprak për shikuesit/dëgjuesit mbi gjuhën vulgare apo materialin i cilat mund të duket fyese për disa, ose që programi nuk konsiderohet i përshtatshëm për fëmijët.

I/KS nuk publikon ose transmeton imazhe të eksplicite dhe/ose shqetësuese si trupa të vdekur, njerëz të plagosur rëndë, pamje të bombardimeve dhe/ose sulmeve etj., për qëllimin e vetëm të tronditjes së audiencës. Përdorimi i këtyre imazheve duhet të vlerësohet rast pas rasti dhe të nënshkruhet nga kryeredaktori ose drejtori, nëse konsiderohet veçanërisht i ndjeshëm/shqetësues. Për përdorimin e tyre duhet të ketë një justifikim të fortë dhe të qartë redaktorial.

Kujdes i veçantë duhet t'i kushtohet identifikimit të paqëllimshëm të viktimave, veçanërisht kur ekziston rreziku që të afërmit e tyre nuk janë njoftuar ende. Të drejtat e privatësisë duhet gjithashtu të respektohen dhe rreziku i tronditjes së të mbijetuarve apo i familjarëve të tyre duhet të peshohet në mënyrën e duhur përballë shqetësimeve redaktoriale që lidhen me zbulimin e së vërtetës dhe mbulimin e duhur të rëndësisë së ngjarjes. Shikoni udhëzimin për raportimin e ngjarjeve tragjike/katastrofave.

Nëse programet apo artikulli/reportazha mund të ndiqen nga fëmijët, duhet të ndërmerret përkujdesje e posaçme për të vendosur nëse imazhet janë të përshtatshme dhe duhet t'i kushtohet rëndësi faktit nëse ekzistojnë marrëveshje në fuqi, të cilat ndalojnë përdorimin e imazheve të hollësisht seksuale, të dhunshme ose ndryshe shqetësuese përpara një kohe të caktuar gjatë mbrëmjes.

Po ashtu, gazetarët duhet t'u drejtohen redaktorëve më të lartë ose drejtorit për udhëzime në rastet kur shkruajnë recensione për libra, shfaqje apo filma të cilët përmbajnë shprehje të pahijshme në tituj, duke përfshirë edhe rastet kur duhet të përdorin asteriske, për shembull: Të bësh pazar dhe të Pa**osh ose Shk*****ta me kapelë.

Në situata të transmetimit të drejtëpërdrejt televiziv apo transmetimit të drejtëpërdrejt online, gazetarët do të sigurohen që të zbatohen të gjitha rregulloret e KPM-së (Komisionit të Pavarur për Media) dhe të Këshillit të Mediave të Shkruara të Kosovës në atë mënyrë që nëse një palë e tretë ka bërë ndonjë shkelje gjatë transmetimit të drejtëpërdrejt, gazetarët do të insistojnë që të bëhet një korrigjim i menjëhershëm dhe do të parashtrojë kërkesën që kjo mos të përsëritet. Në rast që është bërë ndonjë gabim i papërmirësueshëm gjatë transmetimit LIVE, materiali do të fshihet nga online dhe do të zëvendësohet nga një material i ri-edituar në mënyrë të rregullt që do të përmbajë një shpjegim të qartë për arsyet se pse dhe kur është zëvendësuar materiali.

BASHKËPUNIMI PËRTEJ KUFINJVE, PROCEDURAT E MENAXHIMIT REDAKTORIAL

Linjat e raportimit në redaksi, nënshkrimi redaktorial, kontrolli përtej kufijve

Në mënyrë që të sigurohet në përfshirje e përgjithshme dhe përmbajtje e plotë me Politikën Redaktoriale, gazetarët duhet të sigurohen që të kenë aprovimin redaktorial nga redaktorët relevant për të gjitha iniciativat që kanë të bëjnë me verifikim faktesh dhe me hulumtime. Gazetarët do të propozojnë idetë dhe sygjerimet e tyre në formë të shkruar apo forma të tjera të redaktorët e tyre, duke i siguruar që të kenë interesin publik si udhëzuesin kryesor gjatë përgatitjes së artikujve/storjeve televizive. Redaktorët duhet të sigurohen që çdo refuzim i ideve dhe sygjerimeve të dhëna nga gazetarët të përcillet me shpjegime të detajuara mbi arsyet e këtij veprimi.

E gjithë përmbajtja, për televizion, radio, verifikim faktesh, publikim online apo në shtypin e shkruar duhet të nënshkruhet dhe të miratohet përpara publikimit/transmetimit nga redaktori përgjegjës i caktuar nga drejtori. Nuk ka asnjë përjashtim nga ky rregull dhe vendimi i redaktorit përgjegjës është përfundimtar, si në publikime ashtu edhe në transmetime, ndonëse ai/ajo mund të vendosë që t'i referohet kryeredaktorit apo drejtorit nëse është e nevojshme.

Redaktorët dhe/ose kryeredaktori pritet që të testojnë fuqinë e artikullit/reportazhës dhe të burimeve si dhe mbrojtjet e mundshme ndaj çdo veprimi ligjor potencial, si rastet e shpifjeve dhe gjithmonë ta njoftojnë drejtorin për situata të tilla potenciale.

**“Edhe në rast të pajtueshmërisë së plotë me propozimin apo idenë,
është detyrë e secilit që ta sfidojë propozimin apo idenë
sa më vrazhdë që është e mundur me të gjitha argumentet potenciale!
Nëse një propozim apo ide dështon të argumentohet – ajo do të hudhet poshtë!
Nëse idea kalon suksesshëm dhe justifikohet,
atëherë do të ndiqet nga të gjithë stafi me entuziazëm dhe energji të njëjtë”!**

Redaktorët pritet të gjykojnë se kur duhet të përfshijnë drejtorin, por përgjegjësia përfundimtare për publikimin/transmetimin e artikullit/reportazhës së kontestueshme ose të hulumtimeve komplekse bie mbi drejtorin, të cilit i kërkohet që të trajtojë çdo ankesë/ çështje ligjore së bashku me kryeredaktorin, redaktorin dhe/ose autorin.

Nga gazetarët kërkohet të kuptojnë plotësisht procedurat e nënshkrimit dhe të dinë se cili redaktor është përgjegjës për secilin lloj të përmbajtjes, lajmeit, reportazhës, komentit e hulumtimit.

Të gjithë artikujt/reportazhat do të kenë emrin e autorit në krye. Atëherë kur ekziston rrezik serioz i mundshëm për sigurinë e gazetarit, kjo duhet t'i referohet drejtorit për të përcaktuar që kur rreziku është i madh të përdoret nënshkrimi për autorësi anonime si Ekipi i I/KS ose Stafi i reporterëve të I/KS. Këto situata duhet megjithatë të jenë të rralla dhe me distancë në kohë.

Përveç kësaj, botimet e I/KS do të përdorin frazën “i tha I/KS-it” apo “i tha KALLXO” në artikujt dhe materialet e tjera, përveçse në rastet kur përmbajtja është e prodhuar si pjesë e një projekti të përbashkët, kur botimet do të përdorin frazën e dakorduar me organizatën(at) partnere.

Miratimi i detyrueshëm redaktorial

Nëse gazetarët janë duke punuar me materiale që bazohen në burime anonime, veçanërisht nëse përdoret një burim anonim i vetëm, miratimi nga kryeredaktori ose drejtori përpara publikimit/transmetimit është i detyrueshëm. Nëse artikull/ireportazha është veçanërisht e ndjeshme ose e diskutueshme, redaktori përgjegjës duhet ta referojë atë te drejtori për miratim redaktorial përfundimtar. Shiko kapitullin mbi burimet anonime.

Çdo projekt që përfshin raportim ose xhirim të fshehtë duhet të referohet te drejtori përpara fillimit të punës raportuese.

Drejtori duhet gjithashtu të këshillohet për kufizimet ligjore vendase në përdorimin e kamerave të fshehta apo raportimeve të fshehta. Drejtori duhet gjithashtu të jetë i bindur se ka një interes të fortë redaktorial dhe publik për përdorimin e këtyre teknikave dhe të japë miratim të shkruar përpara fillimit të punës raportuese.

Gazetarët duhet të konsultohen me redaktorët nëse kanë të bëjnë me burime ku ekzistojnë shqetësime të mundshme ligjore, të cilat mund të përfshijnë shkelje të mundshme të ligjeve për sinjalizuesit apo të sekreteve zyrtare. Nëse ka shqetësime serioze, përfshirë aftësinë e I/KS për të mbrojtur burimet apo raste të shkeljeve të mundshme të ligjeve, drejtori duhet të ketë fjalën e fundit nëse do të vazhdohet, ndoshta mbi bazën e marrjes së këshillave ligjore dhe/ose kryerjes së hulumtimeve të mëtejshme, ose të ndalohet puna e raportimit.

Nëse ka konflikt të mundshëm ose të perceptuar interesi, drejtori duhet të vendosë nëse artikulli/reportazha do t'i caktohet një gazetari tjetër ose ekspozimi i këtij interesi në material është i mjaftueshëm. Vendimi i drejtorit është përfundimtar.

Siç është theksuar edhe më lart, të gjitha artikujt/reportazhat e ndjeshme, çdo hulumtim dhe situatë që mund të përfshijë burime të vështira duhet të nënshkruhet nga drejtori përpara publikimit dhe/ose transmetimit.

Alarmet menaxheriale për artikuj/reportazha diskutabile dhe me ndjeshmëri të lartë

Artikulli/reportazha që ka gjasë të provokojnë reagim të fortë prej autoriteteve të ndryshme, duhet të miratohen dhe nënshkruhen për saktësi dhe balance nga drejtori.

Gazetarët dhe redaktorët e caktuar duhet të informojnë drejtorin përpara se të botojnë artikuj/reportazha të cilat mund të provokojnë reagime kundërshtuese ose kërcënime për veprime ligjore. Drejtori duhet të vlerësojë se çfarë lloj përfshirjeje ose ndihme është e nevojshme. Kjo do të lejojë që menaxhmenti i lartë dhe zyra ligjore e I/KS të përgatitet paraprakisht për përgjigje ndaj çdo kundërshtimi të mundshëm-si dhe të lajmërojë donatorët kur shihet si e nevojshme.

Kontrollimi i fakteve dhe miratimi i artikujve/reportazheve kundërthënëse apo komplekse

Publikimi/transmetimi i artikullit/reportazhit diskutabil dhe hulumtimeve komplekse duhet të miratohen nga drejtori. Kontrollimi i fakteve është i detyrueshëm për të gjithë artikujt/reportazhet kundërthënëse apo komplekse, përfshirë të gjitha hulumtimet.

Artikujt/reportazhat e këtij lloji nuk duhet të nënshkruhen asnjëherë nga redaktorët me përvojë të vogël apo ata që mbulojnë lajmet e ditës. Drejtori duhet të konsultohet me zyrën ligjore të I/KS për këshilla ligjore.

MBULIMI DHE PËRDITËSIMI I LAJMIT TË FUNDIT DHE LAJMEVE NË ZHVILLIM

Menaxhimi i lajmit të fundit

Gjatë mbulimit të lajmit të fundit, artikulli/reportazhi duhet të përditësohet me t'u shfaqur të informacionit të ri. Sidoqoftë, sapo të identifikohet “një kënd i ri” domethënës, një artikull/reportazh i freskët duhet të shkruhet dhe publikohet, bashkë me versionin e vjetër të arkivuar.

Në fillim, lajmi i fundit duhet të vendoset në “live blog” apo në format të ngjashëm, në mënyrë që I/KS të mund të reagojë shpejt përmes prodhimit të një ose pak paragrafeve shtesë. Më pas, publikohet një artikull/reportazh me së paku katër paragrafë të shkurtër nëse lajmi i fundit konsiderohet mjaftueshëm i rëndësishëm, duke përdorur grafikën e lajmit të fundit, nëse nuk ka fotografi në dispozicion për ilustrim adekuat.

Artikulli/reportazha duhet të përditësohet me informacion të freskët dhe foto të shtuara, por sapo të shfaqet një linjë e re (një sulm i raportuar me armë kthehet në një seri vrasare ose zyrtarisht bëhet një sulm i dyshuar terrorist) një lajm i ri duhet të publikohet dhe versioni i vjetër duhet të kalojë në arkiv.

Gazetarët e I/KSt duhet qartësisht të identifikojnë burimin e raportimit të lajmit të fundit si agjencitë, mediat e tjera, por duhet të angazhohen menjëherë për të konfirmuar artikullin/reportazhin në mënyrë të pavarur.

Katastrofat/ ngjarjet tragjike

I/KS pret që gazetarët dhe redaktorët të raportojnë mbi katastrofat dhe ngjarjet tragjike si luftërat, fatkeqësitë natyrore, sulmet dhe aksidentet me ndjeshmërinë dhe tonin e duhur, pa u përfshirë shumë në emocionet e momentit dhe pa e tharë realitetin e ngjarjes në raportim. Në mbulim duhet të arrihet balancimi i duhur.

Gazetarët dhe redaktorët duhet të jenë të kujdesshëm dhe të mos identifikojnë personat e vrarë, si përmes emrit ashtu edhe fotografive, derisa të afërmit e tyre të jenë informuar. Me aksidentet ajrore dhe ngjarjet e ngjashme, gazetarët dhe redaktorët mund të përfshijnë detaje të tilla si numri i fluturimit, koha e nisjes dhe të ngjashme, që nënkupton se mbulimi i I/KS nuk alarmon në mënyrë të panevojshme ndonjë numër më të madh lexuesish/shikuesish.

Numri i të vdekurve dhe emrat verifikohen përmes, dhe u atribuohen burimeve zyrtare si policia apo ekipet e shpëtimit, autoritetet qeveritare apo burime të tjera të besueshme. Numri i vdekjeve duhet të përditësohet rregullisht dhe të përdoren shifra të përafërta nëse totali nuk është ende i qartë. Përafrime të tilla si “duzina”, “qindra” janë të pranueshme, por duhet të jenë shpesh në citime, përfshirë edhe në tituj-nëse është e përshtatshme të theksohet se numri nuk është ende i konfirmuar dhe se vlerësohet të jetë i përafërt dhe kjo duhet t'i atribuohet citimit të një personi të intervistuar ose ndonjë burimi të ngjashëm.

Mos përdorni termin “terrorizëm” pa ia atribuuar atë një burimi kredibil dhe mos supozoni se një ngjarje tragjike është një akt terrorist, derisa kjo të mund të atribuohet. Edhe kur autoritetet deklarojnë se një ngjarje është akt terrorist, I/KS do të përpiqet të shmangë përdorimin e termit jashtë citimit, duke preferuar përshkrime më pak emotive, të tilla si “i armatosuri”, “bombarduesi”, “pengmarrësi” apo “autori i sulmit”.

I/KS nuk do të përdorë apo publikojë materiale të prodhuara nga kriminelë apo grupe terroriste pa e analizuar mirë impaktin dhe interesin publik të publikimit të tillë. Drejtori duhet të konsultohet dhe të miratojë rastet e tilla para publikimit.

I/KS pret që gazetarët të kërkojnë dëshmitarë okularë sa më parë që të jetë e mundur, si në skenën e krimit ashtu edhe përmes platformave digjitale. Kur kërkohen, të mbijetuarit ose ndoshta të afërm apo miq të pikëlluar/shqetësuar, gazetarët dhe redaktorët duhet gjithmonë të marrin në konsideratë interesin më të mirë të të intervistuarve, të pyesin nëse intervista është e përshtatshme dhe të vlerësojnë nëse ata janë duke kaluar një traumë të fortë ose kanë nevojë për kujdes të menjëhershëm mjekësor. Ngacmimi apo detyrimi me forcë i dëshmitarëve, i të mbijetuarve apo i atyre që kanë humbur një njeri të dashur në një ngjarje tragjike për të dhënë një intervistë është i papranueshëm, nëse ata e kanë bërë absolutisht të qartë se nuk dëshirojnë.

Redaktorët dhe drejtori mund të kenë nevojë të ndryshojnë produksionet e planifikuara ose oraret e publikimit, nëse ngjarja kërkon mbulim të zgjeruar. Naga ata gjithashtu pritet të peshojnë nëse publikimi/transmetimi i një mbulimi të planifikuar para se ngjarja tragjike të ndodhte, do të ishte i pavend.

Në rastet e transmetimit të drejtpërdrejtë nga skena e një ngjarjeje në zhvillim e sipër, ndoshta rrethim apo pengmarrje, redaktorët përgjegjës dhe/ose drejtori duhet të marrin në konsideratë nëse fundi është mjaftueshëm i paparashikueshëm sa të kërkojë shtyrjen në kohë.

Si me të gjitha përdorimet e grafikave dhe imazheve shqetësuese, gazetarët dhe redaktorët pritet të gjykojnë nëse ka motiv të fortë redaktorial për përdorimin e tyre, pra mos përdorni fotografi që mund të shqetësojnë audiencën vetëm për qëllimin e tronditjes. Imazhet duhet të përcjellin siç duhet shkallën e ngjarjes, pa qenë të paarsyeshme.

Me mbulimin e përvjetorëve të ngjarjeve të mëdha, gazetarët dhe redaktorët duhet të konsiderojnë sërish impaktin mbi të mbijetuarit dhe të afërmit, teksa planifikojnë përmbajtjen. Faktorët që duhet të merren në konsideratë përfshijnë kohën që ka kaluar dhe shkallën e ngjarjes. I/KS pret që gazetarët dhe redaktorët të peshojnë gjithmonë justifikimin redaktorial dhe interesin publik për publikimin/transmetimin e materialeve dhe grafikave shqetësuese.

Përdorimi i materialeve grafike menjëherë pas përmbylljes së një ngjarjeje ose në mbulimin e përvjetorit, për të dhënë kontekstin në artikull/reportazh dhe për të përcjellë realitetin e saj, mund të jetë i justifikuar. Tregimi i momentit preciz të vdekjes ose i grafikave, fotografitë e afërta të vuajtjes ekstreme janë rrallë të pranueshme dhe kërkojnë detyrimisht miratim paraprak të lartë redaktorial, si nga redaktori përgjegjës ashtu edhe nga drejtori.

Kur I/KS ka siguruar material ekskluziv dhe intervista për raportim origjinal të tragjediave me pasoja të gjera, redaktorët duhet të vendosin në rast se planifikojnë t'i ripërdorin ato në mbulimin e përvjetorëve, të njoftojnë të mbijetuarit dhe të afërmit e të vdekurve, nëse intervistat dhe pamjet do të përsëriten në mbulimet mbi përvjetorin.

Përfshini qendrat e informacionit, linjat e ndihmës së shpejtë dhe numrat mbështetës apo lidhje të përshtatshme në raportime, nëse është e nevojshme dhe me vend.

TË INTERVISTUARIT E PAMBROJTUR

Intervistimi i fëmijëve

Është rrallë e pranueshme për gazetarët që të intervistojnë fëmijët që u kanë mbijetuar ngjarjeve tragjike, duke përfshirë luftërat/konfliktet, sulmet fizike apo seksuale. Në vend të tyre, gazetarët do të kontaktojnë profesionistët që punojnë me fëmijët që po marrin veten prej këtyre lloj dramash, për shembull psikologë, grupe të ndihmës/mbështetjes dhe organizata jo-fitimprurëse kredibile, si dhe të flasim me ekspertët e fushës.

I/KS pret që gazetarët t'i japin prioritet mirëqenies, sigurisë dhe interesit më të mirë për të gjithë të intervistuarit e pambrojtur dhe nuk duhet të pyesin fëmijët në mënyrë të tillë, që t'u rrezikojnë trauma të mëtejshme. Si theksohet më sipër, është gjithmonë e preferueshme të intervistohen ekspertë në vend të fëmijëve për të shmangur shkaktimin e dëmeve/traumave të mëtejshme të miturit.

Gazetarët duhet gjithmonë të kërkojnë këshilla te redaktorët përgjegjës se si të veprojnë në raste të tilla raportimi që përfshijnë të miturit. Redaktorët duhet ta referojnë çështjen më lart, te drejtori, kur ka shqetësime mbi përshtatshmërinë.

Fëmija i mbijetuar i një sulmi fizik dhe seksual nuk duhet identifikuar asnjëherë, edhe nëse një agjencia e ndihmës/OJQ mund të këshillojë të kundërtën. I/KS duhet gjithmonë t'i mbrojë subjektet e pambrojtura.

Nëse jeni duke filmuar apo raportuar nga një shkollë, strehimore e fëmijëve apo ndonjë institucion tjetër fëmijësh, gazetarët e I/KS duhet fillimisht të sigurojnë leje të shkruar ose të regjistruar nga drejtori, mësuesi kujdestar ose menaxheri. Kur është e mundur, kjo duhet bërë përpara në kohë, në mënyrë që t'i japë drejtorit/menaxherit kohën e duhur për t'u shkruar prindërve//kujdestarëve/kujdestarëve ligjor etj., që të japin lejen nëse është e nevojshme. Në kërkesën e lejes, qëllimi dhe subjekti i raportimit duhet të jetë absolutisht i qartë, në mënyrë që drejtori/menaxheri të mund të japë miratimin e informuar ose, nëse është e nevojshme, t'u shkruajë prindërve/kujdestarëve/mbajtësve për t'u kërkuar pëlqimin e informuar.

Godinat e shkollave dhe objektet zakonisht nuk konsiderohen vende publike, ndaj edhe kërkohet leje për filmime. Gazetarët dhe redaktorët zakonisht kanë më shumë liri që të bëjnë fotografi apo të xhirojnë në vende publike si koncertet apo ngjarjet e zhvilluara në sheshe publike por duhet të jenë në dijeni të legjislacionit për privatësinë, veçanërisht ligjet që kanë të bëjnë me mbrojtjen e fëmijëve. Në çdo ngjarje, vendimi për përdorimin e fotografive të fëmijëve duhet të gjykohet rast pas rasti nga redaktori përgjegjës.

Xhirimi/raportimi nga shkollat nuk është i përshtatshëm për tema shumë të ndjeshme, por për projekte me më pak ndikim, kur fëmijët nuk ka gjasa të bëhen subjekte të pyetjeve të pandjeshme ose t'u kërkohet të flasim për çështje personale të vështira. Shembuj të temave të përshtatshme mund të quhen një projekt shkolle për mjedisin ose përfshirja qytetare apo këshillat rinorë.

Gazetarët duhet të respektojnë kushtet e lejes për filmim/raportim dhe nuk duhet të identifikojnë fëmijë, nëse prindërit kanë refuzuar të japin pëlqimin ose kur drejtori e di se një fëmijë nuk duhet të identifikohet si ndjekës i një shkolle të caktuar. Menaxhmenti i shkollës duhet të këshillohet për filmime dhe intervista të pranueshme/të papranueshme. Gazetarëve të I/KS mund t'u kërkohet që të dërgojnë paraprakisht fushat e pyetjeve për filmime/raportime. Ata me eksperiencë të vogël në intervistimin e fëmijëve duhet të kërkojnë udhëzime nga redaktorët përgjegjës dhe/ose drejtori.

Nëse filmimi/raportimi mbulon kushtet e këqija të një shkolle nga brenda godinës, gazetari duhet sërish të aplikojë për leje te drejtori/mësuesi kujdestar në kohë të përshtatshme për leje prindërore dhe të respektojë dëshirat e prindërve të cilët nuk dhanë pëlqimin që fëmijët e tyre të filmohen/identifikohen. Stafi i I/KS asnjëherë nuk do të identifikojë fëmijët, pra mbuloni fytyrat, filmoni pjesën e pasme të kokës, por jo fytyrën etj. nëse filmohet nga jashtë ambienteve të shkollës. Këto standarde do të kihen parasysh edhe në vende të tjera, ku sipas legjislacionit në fuqi, individët me të drejtë presin të kenë të drejtën në privatësi, si spitalet, qendrat e mjekësisë familjare, etj..

Nëse publikoni/transmetoni në platforma të shumëfishta, gazetarët/redaktorët duhet gjithashtu të sigurohen që fytyrat janë anonimizuar në të gjitha publikimet, përsirë materialet promovuese të tilla si videot për TV dhe ato për internet.

Asnjëherë nuk është e pranueshme të “nxini derën” një fëmije. Gazetarët e I/KS nuk duhet të përdorin kurrë fotografitë ose intervistat e fëmijëve pa marrë më parë pëlqimin e shkruar ose të regjistruar. Shikoni formularët e dhënies së pëlqimit nga prindërit/kujdestarët e fëmijëve të mitur dhe seksionin mbi raportimin e çështjeve gjyqësore që përfshijnë fëmijë.

Intervistimi i të mbijetuarve të rritur nga përdhunimi dhe sulmet seksuale

Intervistimi i viktimave dhe të mbijetuarve nga çfarëdo forme e sulmit apo publikimi i informacionit rreth këtyre rasteve do të bëhet vetëm në bazë të parimit “mos bëni dëm”, që do të thotë se mbrojtja e integritetit dhe dinjitetit të viktimave do të jetë parimi themelor i raportimit.

I/KS pret që gazetarët t’u përmbahen procedurave në vijim, kur kërkojnë ose realizojnë intervista me viktimat në moshë të rritur/viktimat e supozuara të përdhunimit, dhunës seksuale dhe sulmeve seksuale.

Merrni fillimisht miratim redaktorial: Para kontaktimit ose konfirmimit të të intervistuarve konsultohuni me redaktorin përgjegjës dhe/ose drejtorin për t’u siguruar që intervista është e përshtatshme. Kurioziteti njerëzor nuk është asnjëherë bazë e mjaftueshme për këto lloj intervistash.

Hulumtoni informacionin faktual përpara intervistimit: I/KS pret që gazetarët të kuptojnë faktet dhe akuzat kryesore para intervistimit të viktimave/viktimave të supozuara për të shmangur vënien e të intervistuarve përballë pyetjeve apo shqetësimeve të panevojshme. Gazetarët duhet të jenë plotësisht të përgatitur dhe të vetëdijshëm mbi çështjet e mundshme ligjore. Sigurohuni që keni kërkuar në mënyrë të pavarur informacion dhe statistika të besueshme mbi sfondin që e vendos incidentin specifik/incidentin e dyshuar në një kontekst dhe i jep lexuesit një tablo më të gjerë, e cila duhet të jetë thelbi se pse një gazetar bën intervista të këtij lloji. A është artikulli/reportazha mbi një problem social afatgjatë dhe të vazhdueshëm, një konflikt të armatosur, çështje gjyqësore/dështim? Mblidhni të gjithë informacionin në mënyrë që fushat e pyetjeve tuaja të jenë të qarta dhe të përshtatura me ndjeshmëri.

Sigurohuni që interesi i viktimave/viktimave të supozuara të jetë parësor: Gazetarët e I/KS pritet që të intervistojnë në mënyrë të tillë që dinjiteti i viktimave/viktimave të supozuara të ruhet. I/KS duhet gjithmonë të garantojë sigurinë e tij/saj, ta trajtojë atë me respekt dhe ta mbrojë nga përndjekjet apo ndëshkimi.

Organizoni metodat e kontaktit që nuk vënë në rrezik anonimitetin ose sigurinë: Kjo mund të nënkuptojë kontaktimin e individëve me numra të caktuar telefoni dhe në kohë të caktuara, pa i telefonuar asnjëherë në numrat e shtëpisë apo përmes postës elektronike. Sigurohu që viktimat/viktima e supozuar është plotësisht e pajtimit me metodat e parapërgatitura të kontaktit dhe se ato nuk e ekspozojnë të intervistuarin ndaj asnjë rreziku ose identifikimi, nëse kontribuon në kushtet e anonimitetit.

Jini transparent, dakordoni termat: Gazetarët e I/KS pritet të jenë tërësisht të ndershëm dhe transparentë se si, kur dhe ku do të përdoret intervista dhe se cili është qëllimi i raportimit. Termat që përcaktojnë konfidencialitetin, anonimitetin, qëllimin e intervistës dhe kufijtë e tjerë duhet të diskutohen dhe të dakordësohen përpara intervistimit.

Organizoni një vend të sigurtë dhe të siguruar për intervistën: Intervistat duhet të bëhen në një vend të sigurtë, në një kohë të ditës me të cilën i intervistuari është i qetë. I/KS pret që gazetarët të marrin masa për të garantuar siguri dhe anonimitet, çka përcaktohet se mund të nënkuptojë intervistimin e viktimave/viktimave të supozuara në një kohë të caktuar të ditës dhe në një vend me distancë nga qyteti apo fshati i tyre. Të intervistuarit duhet të jenë në gjendje të sugjerojnë vendin që ata preferojnë dhe të kenë mundësinë që të marrin me vete dikë të besuar në intervistë, nëse ata dëshirojnë. Vendet e intervistimit duhet të jenë private dhe pa asnjë rrezik për ndërprerje.

Sigurori anonimitetin: I/KS duhet të respektojë gjithmonë kërkesat për anonimitet dhe të sigurojë që raportimi nuk do të zbulojë detaje të cilat mund të çojnë potencialisht në identifikimin e viktimave/viktimave të supozuara. Edhe kur viktimat/viktimat e supozuara në moshë madhore heqin dorë nga anonimiteti, I/KS pret që gazetarët të marrin vendime në interesin më të mirë të viktimave/viktimave të supozuara dhe të fshehin identitetet kur ekziston rreziku i dëmtimit/hakmarrjes.

Vlerësoni nëse viktimat/viktima e supozuar është e aftë të japë pëlqimin e informuar: Gazetarëve u kërkohet që të vlerësojnë nëse i intervistuari është i aftë që të japë pëlqimin e miratuar për t'u intervistuar (edhe në kushtet e anonimitetit) dhe gjithashtu të jetë i identifikuar (nëse ata kanë treguar se janë të gatshëm). Gazetarët duhet të këshillohen me redaktorin përgjegjës/drejtorin nëse ka shqetësime se një viktimë/viktimë e supozuar është e aftë të japë pëlqimin e informuar. Këto shqetësime përfshijnë, por nuk kufizohen vetëm si më poshtë: personat me vështirësi në të mësuar, personat që vuajnë nga çrregullime të stresit post-traumatik, personat e sulmuar së fundmi, apo janë të pambrojtur në kuptim të ndërgjegjësimit për media. Nëse ka shqetësime të mjaftueshme, redaktori përgjegjës/drejtori mund të vendosë kundër vazhdimit të intervistës ose të këmbëngulë për anonimitet të plotë.

Merrni pëlqimin e informuar: Gazetarët e I/KS duhet të marrin "pëlqimin e informuar" në formë të shkruar ose në video. Kur i intervistuari është duke folur në kushtet e anonimitetit, pëlqimi duhet regjistruar në video, pa e identifikuar viktimën (përmes filmimit të siluetës, pjesës së pasme të kokës etj.).

Sigurohuni që pëlqimet në video ose në formë të shkruar të jenë të plota. Vijimi është një përmbledhje e shkurtër e asaj që përbën një pëlqim të informuar:

1. Sigurohuni që keni zbuluar qëllimin dhe përdorimin e intervistës, përfshirë se ku dhe si ajo do të publikohet dhe/ose transmetohet.

2. Të intervistuarit duhet të deklarojnë se ata e kuptojnë që pjesëmarrja është plotësisht vullnetare dhe se pjesëmarrja nuk do të ndikojë në marrjen e ndonjë shërbimi apo rezultatin e procedurave zyrtare.
3. Të intervistuarit duhet të deklarojnë qartësisht nëse ata kanë vullnetin apo jo që të identifikohen. Nëse ata nuk duan të identifikohen, mënyra se si identiteti i tyre do të mbrohet duhet të dakordësohet (vetëm siluetë, vetëm duart, fytyrë të sfumuar, zë të ndryshuar, përdorimi i një zëri të ndryshëm, etj.).
4. Të intervistuarit duhet të demonstrojnë, duke iu përgjigjur pyetjeve se ata i kuptojnë implikimet e pjesëmarrjes, veçanërisht nëse materiali do të vendoset në internet. Ata duhet të kuptojnë se kanë të drejtën që të anulojnë ose të kufizojnë përdorimin e pamjeve në të ardhmen, por duhet të kuptojnë plotësisht se nuk është zakonisht e mundshme heqja e një materiali përfundimisht nga interneti.
5. Sigurohuni që të intervistuarit të kuptojnë se ata mund të refuzojnë t'i përgjigjen çdo pyetjeje, mund të ndalojnë në çdo kohë për pushim dhe se nuk janë nën presion për të diskutuar mbi diçka për të cilën ata nuk ndjehen rehat që ta diskutojnë.

Referojuni pëlqimit të shkuar të I/KS dhe pëlqimit në dokument video për intervistimin e të mbijetuarve të përdhunimit/sulmit seksual.

Përdorni gjuhë të përshtatshme: Shumica e viktimave të përdhunimit ose sulmeve seksuale preferojnë që t'u referohet si i mbijetuar më shumë se sa si viktimë. Përdorni gjuhë korrekte, jo-paragjyquese dhe kurrë mos përshekruani diçka në mënyrë të tillë që implikon ose sugjeron se të mbijetuarit mund të fajësohen në ndonjë mënyrë për dhunën/sulmin.

Pyetje jo-agresive, por kritike: Ndërsa disa pyetje kritike mund të jenë të përshtatshme në rrethana të caktuara, asnjëherë mos përdorni teknikat agresive të intervistimit mbi subjektet. Për shembull, mund të jetë e përshtatshme të pyesësh me kujdes se pse ankuesi po shfaqet pasi ka kaluar një kohë e konsiderueshme nga ndodhja e incidentit të dyshuar, por nuk ka gjasë të jetë e përshtatshme vendosja në pikëpyetje, në mënyrë agresive e besueshmërisë së tyre në vetvete. Dakordësoni paraprakisht qëllimin e intervistës dhe radhën e pyetjeve me redaktorin përgjegjës dhe/ose drejtorin për të siguruar se ato janë të përshtatshme për raportin e planifikuar.

Mos e dobësoni apo fryni artikullin/reportazhën: I/KS pret që gazetarët të arrijnë ekuilibrin e duhur kur vjen puna të përfshirja e përshekrimit të një sulmi etj. Shumë detaje janë thjesht shfrytëzuese, sensacionale, të panevojshme. Mungesa e detajeve mund të minojnë ose zhvlerësojnë përpjekjet e bëra nga i mbijetuari për të zbuluar atë që ai/ajo ka përjetuar dhe mundet gjithashtu të përfundojë duke minuar besueshmërinë e tij.

Sigurohuni që të intervistuarit të kenë kontaktet e ekipit redaktorial Viktimat/viktimat e supozuara duhet të jenë në gjendje të kontaktojnë ekipin redaktorial, përfshirë gazetarin intervistues, nëse ata kanë ndonjë shqetësim, pyetje, ose nëse kanë nevojë të informojnë në mënyrë urgjente I/KS mbi ndryshime të rrethanave. Të intervistuarit mund të duan ose të kenë nevojë që të anulojnë pëlqimin për t'u identifikuar, ose të anulojnë lejen për të përdorur intervistën dhe ata duhet të jenë të aftë që të kontaktojnë lehtësisht me ekipin redaktorial dhe të flasim me ata që njohin/u besojnë.

Linjat e ndihmës dhe informacioni mbështetës: Jepuni përdoruesve, shikuesve, dëgjuesve kontakte të dobishme informacioni për ndihmë apo organizata mbështetëse, rrjete dhe organizata bamirëse në zonën/vendin e tyre. Gazetarët dhe redaktorët duhet të marrin në konsideratë nëse të intervistuarit kanë qasje në këto organizata si dhe të vendosin nëse është e përshtatshme t'i informojnë rreth tyre.

Në rastet kur viktimat kanë treguar që nuk ndihen mirë pas publikimit apo në rast kur publikimi ka shkatkuar ndonjë formë të traumës apo ndonjë parahatje tjetër për viktimat, redaktori dhe drejtori do të vendosin nëse publikimi duhet të fshihet plotësisht në mënyrë që të sigurohet mbrojtja e duhur për viktimën.

FOTOGRAFITË

Ankesat, privatësia dhe pretendimet për kompensim

Përdorimi i fotografive që padrejtësisht i lidhin njerëzit me veprimtari kriminale apo moralisht të dyshimtë është një burim shumë i zakonshëm i ankesave dhe i pretendimeve për kompensim (shpifje përmes fotos). Ekzistojnë gjithashtu disa konsiderata mbi privatësinë, të cilat duhet të merren parasysh.

Fotografitë që shfaqin fëmijë janë gjithashtu shumë të kontestueshme dhe për të gjitha fotografitë e bëra nga ekipi i I/KS kërkohet miratimi i publikimit i dhënë nga prindërit apo kujdestarët e fëmijëve. Thyerja e ligjit të autorësisë dhe përdorimi apo transformimi i fotografive në kontekst të papërshtatshëm janë gjithashtu burim i shumë ankesave.

Përdorimi i fotografive që paraqesin modele profesioniste, pra jo “njerëz të vërtetë” jo domosdoshmërisht ju mbron nga ankesat për shpifje përmes fotografive (shikoni kapitullin tjetër mbi botimin e fotografive shpifëse) nëse ata mund të kundërshtojnë me argumente kontekstin në të cilin fotografitë janë përdorur. Për shembull, nëse “një fotografi arkivë” që shfaq një model profesionist ose një aktor përdoret për të ilustruar një artikull/reportazh pedofilie, aktori mund të ankohet për dëmtim reputacioni për shkak të kontekstit në të cilin është përdorur.

Gazetarët janë përgjegjës për të atribuar burimin e fotografive, edhe kur të intervistuarit i kanë fotografuar ata vetë, kur sigurojnë fotografi zyrtare ose i marrin ato nga agjencitë pa pagesë. Redaktorët janë përgjegjës për kontrollimin e burimit të fotografisë me gazetarët, nëse ai nuk është i përcaktuar. Për lajmet e ditës, gazetarët janë përgjegjës për kontrollimin e kufizimeve të autorësisë dhe shmangien e shpifjeve, por përgjegjësia përfundimtare qëndron mbi redaktorin.

Fotografitë shpifëse

Janë një ndër burimet më të shpeshta të ankesave. Jini të kujdesshëm veçanërisht se si mund të perceptohen fotografitë ngjitur me titujt/paragrafët përmbledhës që pretendojnë për sjellje kriminale, tinëzare apo moralisht të dyshimta dhe pyetni nëse personi/njerëzit të cilët mund të identifikohen lehtësisht për fytyrë mund të ankohen me arsye.

Një shembull që solli ankesë të suksesshme për kompensim ishte një artikull/reportazh kur fotografia kryesore ishte vendosur ngjitur me një titull që pretendonte praktika finoke mes agjentëve të pasurive të paluajtshme në përgjithësi, pa përmendur askënd në tekst. Fotografia në fjalë shfaqte logon e një agjenti të pasurive të paluajtshme dhe jo një fotografi e përgjithshme e shtëpive apo e tabelave të shitjes pa logo.

Një shembull tjetër përfshin fotografinë e një personi të vendosur gabimisht pranë titullit për një kriminel. Ajo ishte një dëshmitare dhe jo e akuzuara. Fotografitë e njerëzve që mund të identifikohen përmes shfaqjes së fytyrave etj., nuk duhet të vendosen pranë titujve që ngrenë akuza për të cilat ata nuk janë zyrtarisht të akuzuar apo të shpallur fajtorë nga gjykatat. Mbani parasysh se ndonjëherë, individë të akuzuar për kryerjen e krimeve nuk dënohen me vendim gjyqësor, ndaj kontrolloni gjithmonë kufizimet e raportimit.

Titujt dhe fotografitë kryesore

Jini të vetëdijshëm se përdorimi i përshkrimeve në fotografinë kryesore jo domosdoshmërisht e mbron I/KS nga ankesat e këtij lloji.

Film/video

Kujdes duhet treguar në redaktimin e zërit që shoqëron pamjet e temave të filmuara ose në video. Akuzat dhe deklaratat e mbulimeve me zë, të vendosura pa lidhje me imazhet, veçanërisht të kompanive apo individëve që mund të identifikohen për fytyrë ose karakteristika të tjera, mund gjithashtu të bëhen burime ankesash për shpifje apo përdorim të padrejtë.

Autorësia

Gazetarët dhe redaktorët janë përgjegjës për përzgjedhjen e imazheve që mund të përdoren nga I/KS, të cilat janë të mbuluara nga marrëveshjet e licencimit me agjencitë e fotografive (pa pagesë ose tarifë) ose janë të lira për t'u përdorur pa pagesë. Pasi të siguroheni se I/KS përdor fotografitë pa thyer ligjet e autorësisë, gazetarët janë përgjegjës për të shënuar se kush e ka autorësinë sipas kërkesave të përcaktuara.

I/KS pret që gazetarët dhe redaktorët t'i përmbahen versionit të fundit të Udhëzimit të Stilit të I/KS kur është e përshtatshme dhe të përdorin drejtshkrim korrekt në formatet e titrimit, përfshirë edhe autorësinë e fotos dhe videos.

Verifikimi i fakteve me video

Para publikimit të fotove apo video materialeve që nuk janë bërë nga stafi I/KS, gazetarët dhe redaktorët duhet të sigurohen që materiali është i saktë dhe që ato nuk janë ndryshuar në asnjë mënyrë, apo që materiali i tillë nuk është produkt i inteligjencës artificiale apo prodhimit të deep fake.

Formularët e pajtimit (dhënia e pëlqimit)

Të gjithë gazetarët e I/KS, përfshirë edhe gazetarët jashtë stafit që janë përzgjedhur apo kontraktuar për të punuar në projekte specifike duhet të marrin pëlqime për të përdorur fotografitë e të intervistuarve apo kontribuesve.

Nëse kontribuuesit njihen si analfabetë, gazetarët duhet të sigurohen, edhe nëpërmjet përdorimit të përkthyesëve nëse është e nevojshme, që ata e kuptojnë (pëlqimin e informuar) dhe të regjistrojnë në video dhënien e pëlqimit.

Gazetarët duhet të pyesin për miratim nga prindërit/kujdestarët në mënyrë që ata të japin pëlqimin e informuar për fëmijët, të cilët normalisht nuk konsiderohen të aftë për ta dhënë vet miratimin, nëse janë nën moshën 18 vjeç. Gazetarët dhe redaktorët e I/KS do të sigurohen që të përdorin format e miratimit për përdorim nga të rriturit dhe/apo kujdestarët/prindërit në gjuhën e duhur.

Identifikimi i fëmijëve në fotografitë e përgjithshme

Stafi i I/KS do të tregojë kujdes të shtuar në rast të përdorimit të fotografive që identifikojnë fëmijë apo shfaqin fytyrat e tyre, edhe nëse nuk flitet për akuza kriminale. Fëmijët nuk duhet domosdoshmërisht të identifikohen dhe sigurisht jo në foto, vetëm sepse prindërit e tyre janë akuzuar si keqbërës. Gazetarët duhet gjithashtu të jenë të përgjegjshëm se si identifikimi i fëmijëve mund të ndikojë për të keq tek opinioni publik ose t'i ekspozojë ata ndaj përqeshjes apo urrejtjes.

Pyesni veten nëse do të donit të njiheshit, e në internet është zakonisht përgjithmonë, si vëllau apo motra e një fëmije që është shitur, abuzuar apo është lejuar të shikojë pornografi në internet? Nëse jeni në dyshim, përdorni fotografi të cilat nuk i identifikojnë fëmijët apo nuk shfaqin fytyrat e tyre dhe merrni këshilla nga redaktorët e lartë përpara publikimit/transmetimit.

Titrat

Gazetarët dhe redaktorët zakonisht shqyrtojnë me kujdes titujt dhe tekstin, por nuk shikojnë ose harrojnë të kontrollojnë nëse titrat e fotove janë a) të gënjeshtërtë b) të pasakta. Vini re se një tekst i shtuar zakonisht nuk ju mbron nga përgënjeshtrimi i fotove, nëse ajo është përdorur si një fotografi e madhe afër një titulli të fortë, që pretendon veprime të paligjshme, tinëzare apo sjellje të dyshuara morale. Kjo është absolutisht e vërtetë për fotografitë e përdorura në faqe ku titrat nuk shihen.

Fotografitë brenda trupit të lajmit – jo ngjitur me titullin, por mjaft poshtë në artikull/reportazh - duhet të kenë titra të përshtatshëm, të cilat qartësojnë nëse personi i fotografuar është ekspert etj. dhe jo një ndër personat e akuzuar. Nëse ka më shumë se një person në fotografi, titri duhet të identifikojë edhe pozicionin e tij në foto [majtas, djathtas, rreshti i parë, rreshti i dytë, ulur, në këmbë, etj.] dhe gazetarët/redaktorët duhet të marrin në konsideratë nëse do të ishte më mirë që të përdornin fotografi tjetër.

Imazhe shqetësuese/grafike

Këto nuk duhet kurrë të përdoren vetëm për vlera tronditëse. Gazetarët e I/KS pritët që t'u përmbahen udhëzimeve të përcaktuara në kapitullin mbi subjektet e ndjeshme, materialet fyese, imazhet eksplicite/shqetësuese.

Fotografitë e siguruarat përmes llogarive në media sociale

Shënoni në titra burimit/autorësinë e fotografisë(ve). Kontrolloni dhe verifikoni përmbajtjen digjitale. Shumicën e kohës, kjo përfshinë kontrollin nëse llogaria në rrjetet sociale është origjinale, kontrollimin e fakteve, gjurmimin dhe kontaktimin e burimit origjinal. Qendra Europiane e Gazetarisë ka publikuar disa udhëzues të dobishëm në internet: <http://verificationhandbook.com/>

BURIMET

Pagesat për intervistat/shpenzimet për burimet

I/KS nuk paguan për intervistë, por me raste mbulon shpenzime të arsyeshme - udhëtime dhe strehim-për kontribuuesit dhe burimet.

Ekspertët/kontribuuesit

Gazetarët e I/KS pritet që të mbajnë një rrjet të gjerë me ekspertë kontribues, të cilët mund të japin komente të thella mbi lajmet, etj.. Gazetarët duhet të kontrollojnë kredencialet e kontribuuesve për t'u siguruar që ata nuk do të mashtrohen kurrë si dhe në mënyrë që çdo përkatësi politike apo interesa të tjera të shënohen në çdo material të publikuar ose të transmetuar. Për verifikimin e kredencialeve të kontribuuesve, gazetarët duhet të bëjnë kontrolle të tërthorta të burimeve të besueshme ekzistuese dhe të mos e bazojnë kontrollin vetëm tek individët e përmendur nga kontribuuesi i mundshëm.

Mbajtja e një rrjeti të qëndrueshëm dhe të gjerë kontaktesh bazohet te gazetarët që u përmbahen standardeve të gazetarisë të përcaktuara nga I/KS në mbulimin e saktë, të paanshëm dhe transparent. Gazetarët e I/KS nuk duhet të shpërdorjnë të njëjtët ekspertë. Citimet e vazhdueshme të vetëm një apo dy ekspertëve minojnë prodhimet e I/KS dhe vënë në diskutim besueshmërinë e gazetarit.

Të gjitha kontributet e ekspertëve duhet të paraqiten me saktësi dhe të përfshihen mbi bazën e ofrimit të njohurive të reja dhe të dobishme në një artikull/reportazh të veçantë. Gazetarët pritet të mbajnë shënime të plota – përfshirë regjistrim – të intervistave për të siguruar saktësi si dhe për të mos humbur çështjet kryesore të thëna nga kontribuuesit. Pa mbajtjen e saktë të citimeve, në formë të shkruar apo të regjistruar, gazetarët rrezikojnë të thjeshtëzojnë citimet e ekspertëve ose madje të humbasin çështjet më të rëndësishme të ngritura prej tyre.

I/KS pret që gazetarët të sigurohen se të gjithë kontribuesit e kuptojnë qartësisht se ata do të citohen dhe emërtohen në një çështje të publikuar/transmetuar. Kontribuuesit duhet të informohen se se kur dhe ku do të publikohet/transmetohet artikulli dhe temën(at) që ai mbulon.

Gazetarët duhet të sigurohen që emri i plotë i kontribuuesit si dhe profesioni dhe vendi i punës të përfshihen në të gjitha materialet. Shikuesit/lexuesit kanë të drejtën të gjykojnë vetë mbi besueshmërinë dhe statusin e kontribuuesit.

Informacionet jo-zyrtare / konfidenciale

I/KS pret që gazetarët të konfirmojnë informacionet e marra në mënyrë jozyrtare apo konfidenciale sa më shpejt që të jetë e mundur. Gazetarët duhet të vlerësojnë burimin, ekspertin e mirënjohur dhe të besueshëm apo anëtarin anonim të publikut dhe të punojë për të hetuar sa më mirë çështjen. Gazetarët duhet të kërkojnë këshillat e redaktorëve përgjegjës dhe/ose drejtorit në përputhje me rëndësën e pretendimeve. I/KS nuk ofron shpërblime në para për sugjerimin e artikullit/reportazhës.

Burimet anonime

Rregulli i përgjithshëm i përdorimit të burimeve anonime është i tillë që kërkon të paktën dy burime të pavarura që të konfirmojnë faktin/informacionin para publikimit. Kini parasysh, gjithsesi, që redaktori përgjegjës ose drejtori mund të këmbëngulin për një konfirmim të tretë, nëse artikulli/reportazha është shumë e diskutueshme ose e ndjeshme.

Si me të gjithë artikujt/reportazhat, redaktori përgjegjës duhet që të miratojë publikimin ose ta referojë artikullin/reportazhin te drejtori për nënshkrim, nëse shihet e nevojshme. Gazetarët e

I/KS duhet të jenë të përgatitur që të përshkruajnë detajisht pozicionin e secilit burim, statusin, besueshmërinë dhe përfshirjen e tij në artikull/reportazh.

Për artikull/reportazh me një burim të vetëm, sinjalizuesi/informatori duhet të jetë një politikëbërës aktual ose pjesmarrës në veprime apo negociata me njohuri të dorës së parë, ose një zyrtar përfaqësues apo një zëdhënës i cili flet për prapavinë e artikullit/reportazhit. Një informacion i tillë duhet t'i nënshtrohet një shqyrtimi të veçantë për t'u siguruar që ekziston një interes publik i mjaftueshëm për të publikuar artikullin/reportazhin dhe se I/KS nuk po manipulohet me qëllimin e publikimit të artikullit/reportazhës thjesht shkatërruese apo madje të rreme. Drejtori ose redaktori përgjegjës është i detyruar ta miratojë kopjen në formë të shkruar.

Gazetari duhet të zbulojë identitetin e burimeve të tij, me kërkesë të drejtorit/redaktorit.

Artikulli/reportazhat e bazuara vetëm në një burim anonim duhet të jenë një përjashtim nga rregulli dhe kërkojnë miratimin e drejtorit si dhe të marrin në konsideratë faktorë të cilët përfshijnë përvojën e burimit por edhe të reporterit. Në rastet kur autori është korrespondent me përvojë dhe me një artikull/reportazh të qëndrueshëm i cili i referohet një burimi të besueshëm, miratimi për publikim/transmetim mund të jepet nga redaktori i lartë përgjegjës dhe drejtori për të siguruar që I/KS mbetet konkurrues në publikimin me kohë/shpejtësi.

Megjithatë, redaktori përgjegjës dhe/ose drejtori mund të vendosin që ta mbajnë artikull/reportazhën në pritje për verifikime të mëtejshme.

Gazetarët e I/KS nuk duhet asnjëherë t'u premtojnë burimeve anonime se artikulli/reportazha do të publikohet. Kur burimet anonime nuk lejojnë që gazetari të zbulojë identitetin e tyre në asnjë rrethanë - qoftë edhe vetëm te drejtori - gazetari duhet të deklarojë qartësisht se drejtori nuk do ta publikojë ose transmetojë atë.

Atëherë kur gazetarët duhet të mbrojnë identitetin përmes përdorimit të burimit anonim, ata duhet të sigurohen që t'i tregojnë lexuesve/shikuesve sa më shumë të mundën rreth nivelit të tyre të autoritetit/ekspertizës. Ata nuk duhet të hutojnë audiencën rreth statusit të burimit.

Gazetarët duhet qartësisht të bien dakord mbi sigurimin e kohëzgjatjes së anonimitetit dhe të përcaktojnë nëse burimi duhet të mbetet i paidentifikueshëm për publikun e gjerë apo gjithashtu për miqtë e ngushtë dhe familjen. Gazetarët duhet të mbajnë shënime të sakta mbi kushtet e anonimitetit dhe të mos e premtojnë atë, nëse I/KS nuk do të ketë mundësinë të respektojë kushtet e dakorduara - siç mund të jetë rasti i vendosjes nën një urdhër gjyqësor që kërkon zbulimin e materialit të papërdorur.

Gazetarët duhet të këshillohen me redaktorët dhe/ose drejtorin rreth sigurisë dhe mbajtjes së të dhënave të siguruara nga burimet anonime. Mund të ketë raste mjaft të ndjeshme, kur drejtori i I/KS do të këmbëngulë që të mos mbahet asnjë shënim/dokument, dokument elektronik dhe asgjë tjetër që identifikon një kontribuues ose burim, në mënyrë që të ketë mundësinë të mbrojë burimet legjitime dhe ndonjëherë të pambrojturit. Kjo mund të përfshijë gjithashtu blloqet e shënimeve, materialet audio/video dhe dokumentet administrative të punës.

Burimet e inteligjencës

Pas pranimin të informacioneve apo raporteve nga burimet e inteligjencës, ato gjithmonë do të vlerësohen bazuar në besueshmërinë e burimit, interesin publik dhe relevancën. Të gjitha rastet kur informacionet nuk janë të verifikueshme, do të jenë subjekt i miratimit dhe nënshkrimit nga zinxhiri redaktorial dhe drejtori. Një njoftim i duhur do të publikohet oër të shpjeguar që informacion bazohet në burime të inteligjencës.

Burimi i statistikave/informacioni faktual

Gazetarët e I/KS pritët që statistikën kryesore që mund të kontestohen t'ua atribuojnë burimeve krebibile. Për shembull, vlerësimet e Kombeve të Bashkuara për numrin e refugjatëve, statistikën qeveritare për shifrat e papunësisë (ndoshta duke i ballafaquar me vlerësime të tjera të besueshme nga institucione të njohura në rastet kur ka dallime). Wikipedia nuk është një burim i pranueshëm i fakteve.

Kur statistikën janë të konfirmuara dhe të pakontestuar - për shembull numri i të vdekurve në një incident të kaluar si sulmi terrorist i nëntorit 2015 në Paris, apo shifrat e pakontestuar të popullsisë - gazetarëve zakonisht nuk u kërkohet që t'i atribuojnë ato në mënyrë direkte.

Nëse shifrat janë të kontestuar - shembujt përshijnë madhësinë e popullsisë në një territor të debatueshëm, totali i kontributeve të vendeve anëtare të BE-së ose shifrat totale të ndihmës në dëmshpërblimin e fatkeqësive, ku mund të përdoren llogaritje të ndryshme - listoni madhësinë/sasinë mesatare dhe theksoni se pse ka kundërshtime për shifra.

Kërkohet që gazetarët të shënojnë se nga e kanë siguruar informacionin faktual, të tillë si fitimet/humbjet e kompanisë, shkurtimet e planifikuara të vendeve të punës, pronësia e kompanisë, fëmijët që jetojnë në varfëri, etj.. Këto informacione mund të sigurohen nga burime të tilla si bilanci financiar i kompanisë, dokumente gjyqësore të marra ligjërisht ose të lexuara para gjykatës, raportet e institucioneve të respektuara si Amnesty International, OKB, universitetet etj..

I/KS pret që gazetarët, veçanërisht kur punojnë në format e gjata të gazetarisë, të kontrollojnë çdo pretendim të ngritur nga të intervistuarit. Nëse dikush thotë se vetëm 0.5 për qind e përdhunimeve dhe e ankesave për sulme seksuale përfundojnë në dënime, gazetarëve u kërkohet që të vlerësojnë besueshmërinë e burimit dhe të gjykojnë se kur duhet të kryejnë verifikime për të vërtetuar faktet në institucionet e besueshme, ku përfshihen organizata jo-fitimprurëse me reputacion, dokumente të gjykatës/prokurorisë, etj..

Atribuimi i organizatave të tjera mediatike

I/KS pret që gazetarët të atribuojnë mediat e tjera për çdo material të tyre të përdorur në artikujt/reportazhet e I/KS. Do të përdoren vetëm burimet e njohura dhe kredibile të miratuara parapakisht prej redaktorëve për citim.

Plagjiatura nuk do të tolerohet! Gazetarët e I/KS duhet të jenë transparentë rreth materialeve, ngjarjeve, citimi ose çfarëdo materiali tjetër nëse e kanë marrë nga një organizatë tjetër mediatike. Dështimi në atribim do të trajtohet si plagjiaturë dhe mund të çojë në veprime disiplinore.

Deri sa citimi i një agjencie lajmesh apo medieje tjetër është i pranueshëm për lajmin e fundit, gazetarët e I/KS duhet të punojnë menjëherë që të verifikojnë informacionin në mënyrë të pavarur (për shembull të një shpërthimi, aksidenti ajror apo sulmi terrorist, etj..) me autoritetet apo në terren, nëse është e mundur.

Gazetarët duhet gjithashtu të punojnë për të marrë vet citimet nga dëshmitarët, autoritetet, shërbimet e emergjencës ose burime të tjera legjitime, të cilat janë të përshtatshme për artikull/reportazh.

Kështu, nëse përdorni një media tjetër si burim, artikulli/reportazha fillestare duhet të atribuojë burimin – kjo mund të jetë si më poshtë: “Pesë të vdekur sipas agjencisë së lajmeve XYZ” ose

ngjashëm me këtë. Pasi që I/KS ta ketë verifikuar artikullin/reportazhën përmes informacioneve të mbledhura nga gazetarët e vet, teksti fillestar duhet të arkivohet dhe të zëvendësohet nga një artikull/reportazh që i atribuohet tërësisht I/KS.

Nëse një artikull/reportazh përdor kryesisht burime të I/KS-it - materiale të cilat janë mbledhur nga vetë gazetarët e I/KS - por përfshin disa elementë të marrë nga një media tjetër, secili element i marrë nga burimi i jashtëm duhet të atribuohet brenda artikullit/reportazhës (përfshirë citime, fakte, fotografi etj.). Gazetarët e I/KS duhet të marrin në konsideratë ligjet e së drejtës së autorit kur përdorin materiale nga palët e treta.

Gazetarët dhe redaktorët pritet që të kuptojë kufizimet e ripërdorimit: marrëveshjet me agjencitë dhe të sigurojë se masat kundër plagjiazmit zbatohen në redaksitë e I/KS.

Kontrolli i përmbajtjes digjitale (prodhim i publikut, mediat sociale)

Pamjet, pretendimet dhe materialet e shpërndara nëpër llogaritë e mediave sociale duhet gjithashtu të kontrollohen dhe jo thjesht të merren si të mirëqena. Shumicën e kohës, kjo do të përfshijë verifikimin nëse llogaria është origjinale, kontrollin e fakteve, gjurmimin dhe kontaktimin me burimin origjinal. Qendra Europiane e Gazetarisë ka publikuar një sërë udhëzimesh të dobishme në disa gjuhë të ndryshme për verifikimin e përmbajtjes digjitale: <http://verificationhandbook.com/>

Kërkesat për koment, refuzimet e komentimit

Gazetarët duhet të bëjnë përpjekje të sinqerta dhe të ndershme për të marrë përgjigje kundrejt kritikave apo akuzave specifike të një artikulli/reportazhe. Kjo nënkupton që gazetarët duhet gjithmonë të përfshijnë nëse individët ose organizatat/kompanitë “refuzojnë të komentojnë” ose “nuk përgjigjen”. Kur publikoni një përgjigje specifike mbi një kritikë apo akuzë specifike, është e preferueshme të emërtohet personi që jep përgjigjen, si dhe fakti nëse ai po flet në emër të tij apo të organizatës/kompanisë.

Kur publikoni një reagim të thjeshtë ndaj një pretendimi apo kritike- jo një intervistë apo gjë të ngjashme- përgjigjet nga institucionet e qeverisë duhet të publikohen me emrin e zëdhënësit që e jep përgjigjen. Megjithatë, nëse ata këmbëngulin që citimi t’i atribuohet vetëm zyrës së shtypit, I/KS do ta lejojë këtë, por e dekurajon në përgjithësi këtë praktikë mbi bazën e argumentit se zyrtarët për media paguhën për të folur për media. Gazetarët duhet gjithashtu të shënojnë qartë nëse zëdhënësit u përgjigjen në formë të shkruar apo vetëm lëshuan deklaratë.

Vëreni se shpesh është më mirë që të mbështesni kërkesat verbale për koment me shkrim (me email). Kjo është jashtëzakonisht e dobishme në drejtim të mbajtjes së të dhënave. Mos harroni që të ruani të gjitha kërkesat e shkruara për përgjigje të shpejtë, koment dhe/ose intervistë në një dosje, në mënyrë që I/KS të jetë e aftë të provojë se gazetari në fjalë i është qasur të gjitha palëve për koment/përgjigje.

RAPORTIMI I FSHEHTË, ZËNIA E DERËS DHE GAZETARIA NË PËRCJELLJE

Filmimi sekret/raportimi i fshehtë

Vendimi për të filmuar në mënyrë secrete apo për të raportuar në mënyrë të fshehtë është një veprim serioz. Drejtori duhet të konsultohet dhe të nënshkruajë pajtueshmërinë me shkrim përpara se çdo gazetar i I/KS të angazhohet ose madje të përcaktojë se artikulli/reportazha kërkon përdorimin e këtyre teknikave, pasi ka interes publik të mjaftueshëm dhe se organizata nuk mund të akuzohet se po lëshohet në “ekspedita peshkimi” të pajustificuara apo madje po nxitë dikë/të tjerët që të kryejnë krime.

Drejtori dhe/ose redaktori përgjegjës që ka kompetencën për të vendosur, janë përgjegjës për respektimin e ligjeve dhe rregulloreve që mbulojnë filmimin sekret apo raportimin e fshehtë dhe gjithashtu të përcaktojnë nëse nevojitet këshillim ligjor paraprak. Redaktorët do të kërkojnë miratimin final nga drejtori para publikimit apo transmetimit.

Gazetarët dhe redaktorët duhet të mbrojnë privatësinë e atyre që ndodh të jenë të pranishëm gjatë filmimit me kamerë të fshehtë dhe që nuk janë të përfshirë në mënyrë të drejtpërdrejtë në artikull/reportazh/akuza, etj..

Referojuni seksionit mbi miratimin e detyrueshëm nga stafi i lartë redaktorial.

“Zënia e derës” (përballja) individëve në punë ose shtëpi

Përpara se të ballafaqohen me individët, gazetarët duhet të marrin miratimin në formë të shkruar nga redaktori përgjegjës, i cili mund të ketë nevojë që ta referojë çështjen te drejtori për miratim përfundimtar. Redaktori përgjegjës dhe/ose drejtori duhet të marrin në konsideratë shqetësimet mbi privatësinë - si për personat e shenjësuar për t'u intervistuar ashtu edhe për ata që rastësisht ndodhen të pranishëm si dhe të konsiderojë nëse kjo teknikë është adekuate.

“Zënia e derës” duhet të miratohet vetëm nëse individët kryesorë kanë dështuar t'u japin përgjigje kërkesave për koment mbi akuza të rënda dhe nuk duhet përdorur vend e pavend. Duhet të ketë prova të qëndrueshme të një veprimtarie kriminale të rëndë si dhe duhet të ndiqen procedurat e përshtatshme të vlerësimit të rrezikut. *Referojuni seksionit mbi vlerësimin e rrishtit dhe sigurinë.*

Zakonisht për lajme të ditës e jo për hulumtime, gazetarët mund t'i pyesin figurat publike në mënyrë të arsyeshme në vende publike dhe/ose aktivitete, edhe pa kërkuar më parë takim. Në anën tjetër, zënia e derës e derës përfshirë zyrtarët e figurat publike në shtëpitë apo zyrat e tyre nuk është zakonisht e përshtatshme ose e justifikuar për artikuj/reportazhe që mbulojnë lajmet e ditës.

Shoqërimi i bastisjeve, gazetaria në përcjellje ose gazetaria shoqëruese

Gazetarëve u kërkohet të marrin leje nga drejtori për të shoqëruar apo ndjekur “hap pas hapi” operacione të tilla si bastisjet policore. Termat, kufijtë dhe rregullat duhet të përcaktohen qartë dhe në disa raste, të rregullohen nga marrëveshje formale mes I/KS dhe institucioneve zyrtare (policia, prokuroria etj.).

Duhet të kryhet një vlerësim i rrezikut aty ku është e përshtatshme dhe gazetarët duhet të informohen qartë nga menaxhmenti i lartë redaktorial - drejtori ose redaktori përgjegjës - për respektimin e të drejtave të privatësisë (ndaj atyre që qëllojnë të jenë të pranishëm), fshehjen e identiteteve, marrjen e pëlqimeve, ndalimin e xhirimeve nëse u kërkohet dhe nëse ata duhet të hyjnë në ambiente si shtëpitë private.

Drejtori dhe redaktorët përgjegjës duhet të marrin paraprakisht masa për t'u siguruar që ata nuk po manipulohen dhe të konsiderojnë seriozisht mbi të gjitha argumentin e interesit publik, në ndjekjen e operacioneve.

Ndjekja e oficerëve të rangut mesatar të policisë në aksione, kushtet pak të financuara të punës në aksidente, pavionet e urgjencës në spitale, kushtet e policisë kufitare dhe reportazhe të llojit "një ditë nga jeta" kanë përfitime të qarta të interesit publik, por duhet sërish të konsiderohen me kujdes në termat e privatësisë - dhe të mos identifikojnë individë, të cilët nuk duan apo nuk janë në gjendje të japin pëlqimin e informuar për t'u xhiruar apo intervistuar - ndërkohë që I/KS duhet gjithashtu të mbajë të drejtat e plota të përdorimit.

VLERËSIMI I RREZIKUT DHE PROCEDURAT E SIGURISË

Vlerësimi i rrezikut

Gazetarët dhe redaktorët duhet të ndërmarrin vlerësime të plota të rrezikut, përfshirë mundësinë e dëmtimit të menjëhershëm ose në të ardhmen të individëve në staf apo organizatës. Gazetarët duhet të njoftojnë redaktorët kur janë duke vizituar një vend potencialisht të rrezikshëm apo duke realizuar intervista potencialisht të rrezikshme - duke përfshirë vendin, orën dhe kohëzgjatjen e pritshme të intervistës. Zakonisht, intervistat duhet të kryhen në vendet e punës (në zyrat e subjektit ose të I/KS) ose në vende publike si sallat e pritjes në hotel, kafene apo vende të ngjashme dhe jo në zona të largëta e të izoluar.

Nëse takimi i një burimi konsiderohet potencialisht i vështirë dhe i rrezikshëm, redaktori përgjegjës/drejtori dhe gazetari duhet të përcaktojnë nëse nevojitet mbështetje - qoftë duke raportuar në grup ose duke pasur një person tjetër aty pranë, i cili është i gatshëm të shfaqet apo të kërkojë ndihmë në emër të gazetarit. Kjo mund të përfshijë raportimin në grup dhe nevojën për një vëzhgues të tretë që regjistron dhe është i gatshëm të ndërhyjë drejtpërdrejt ose të kërkojë ndihmë. Gazetarëve u kërkohet që të kontaktojnë rregullisht me redaktorët përgjegjës për të konfirmuar sigurinë e tyre.

Në situatat me rrezikshmëri të lartë - si ballafaqimi në shtëpi apo në vendin e punës të individëve potencialisht të rrezikshëm - redaktori përgjegjës duhet të vendosë nëse nevojitet një "kujdestar" i trajnuar (si punë truproje) ose nëse kolegu është mjaftueshëm i trajnuar apo ka aftësi e njohuri të duhura për ta bërë këtë punë. Mundësitë e transportit dhe planet e daljes duhet të jenë pjesë e vlerësimit të rrezikut, bashkë me masat e përshtatshme rezervë që mund të ndërmerren.

Nëse biseda bëhet e hidhur dhe gjërat marrin për keq, gazetarët duhet të jenë të qartë se ata duhet t'i binden instiktit të tyre dhe të mos e vendosin veten dhe të tjerët në rrezik. Gazetarët që mbulojnë protesta dhe ngjarje masive publike- parada etj. - duhet të jenë të vetëdijshëm se çfarë pritet që ata të mbulojnë e çfarë jo, si dhe të këshillohen për të trajtuar shpërthimet e mundshme të situatës. Kjo përfshin mbajtjen e identifikimit të qartë se ata janë reporterë, qëndrimin në vend të sigurt gjatë protestave të dhunshme, mbrojtjen kundër dhe ndjekjen e procedurave në ngjarje kur përdoret gazi lotsjellës, topat e ujit, etj., dhe të tërhiqen në një largësi të sigurt. Këto duhet të sqarohen në vlerësimet e rrezikut.

Vlerësimet e rrezikut duhet gjithashtu të marrin në konsideratë sigurinë e burimit - veçanërisht kur biseda me gazetar mund t'i vendosë ata në rrezik. Kjo duhet të përfshijë ruajtjen e të dhënave personale apo të detajeve që mund të rrezikojnë sigurinë e një burimi - dhe atë të gazetarit. Në situata të caktuara, komunikimet elektronike duhet të jenë të krijuara. Të gjitha këto vlerësime duhet të jenë në formë të shkruar dhe të firmosen nga gazetari(ët) dhe redaktori përgjegjës/drejtori.

Gazetarët, redaktorët dhe drejtori duhet të plotësojnë formularët e vlerësimit të rrezikut dhe të ndjekin procedurat e përcaktuara. Nëse ndodh ndonjë incident, gazetarët dhe redaktorët/drejtori duhet të plotësojnë një formular të raportimit të incidentit. *Shikoni vlerësimin e përgjithshëm të rrezikut dhe formularët e raportimit të incidenteve.*

Procedurat në rastet kur gazetarët e I/KS janë nën kërcënim/sulm

Çdo anëtar i stafit i të gjitha niveleve që gjendet përballë çfarëdo kërcënimi/sulmi ose sjelljeve shantazhuese duhet menjëherë të informojë eprorin e linjës - pa marrë parasysh sa i parëndësishëm mund të konsiderohet kërcënimi dhe pavarësisht nëse e keni marrë atë përmes postës elektronike, mediave sociale apo në çfarëdo mënyrë tjetër. Menaxheri i linjës duhet më pas të verë në dijeni menaxhmentin e lartë dhe ndoshta të ndihmojë me dërgimin e një ankese në polici - ndoshta me ndihmën e një juristi, nëse konsiderohet e nevojshme në atë pikë.

Drejtori duhet të mbajë shënim për kërcënim të tillë dhe të sigurohet që të dhënat do të arkivohen në arkivën zyrës së I/KS.

E njëjta procedurë duhet të ndiqet kur gazetarët e I/KS bëhen individualisht shënjestra të sulmeve të shkruara nga mediat e tjera.

Ky lloj i mbështetjeje duhet t'u ofrohet gazetarëve dhe stafit të I/KS dhe atyre jashtë tij, të cilët marrin pjesë si bursistw apo pjesëmarrës në raportim.

I/KS ka hartuar procedurat e mëposhtme, të cilat duhet të zbatohen në raste të tilla.

Hapi 1: Hapni një ditar/dosje dhe ruani të gjitha materialet që lidhen me çështjen, ankesat tuaja, printimet dhe fotokopjet e të gjitha dokumenteve ekzistuese, si artikujt kërcënues, telefonatat, regjistrimet audio të këtyre kërcënimeve, fotografi të dëmtimeve (nëse bëhet fjalë për sulm fizik), emaillet, mesazhet. Kjo duhet të shërbejë si një ditar i ngjarjeve që organizata duhet të mbajë për përdorim, nëse rasti shkon në gjykatë.

Hapi 2: Në rastet e kërcënimit të drejtpërdrejt fizik - menjëherë raportojeni rastin në polici. Diskutoni me policinë nëse është e nevojshme një kërkesë për urdhër kufizimi në mënyrë që sulmuesi/personi kërcënues të qëndrojë larg gazetarit. Gazetarët duhet gjithashtu të dorëzojnë një raport në polici, nëse ata janë bërë pre e sulmeve - përfshirë sulmet shpifëse, aty ku është e zbatueshme - nga organizatat mediatike, qoftë në formë artikulli, shënimi, statusi në Facebook dhe/ose thirrje për dhunë dhe/ose nxitje të gjuhës së urrejtjes.

Hapat që duhen ndjekur në këto raste:

- a) Personalisht në stacionin e policisë. Nëse raportimi është bërë personalisht, sigurohuni që të merrni një kopje të vulosur të raportit të dorëzuar.
- b) Preferohet që raporti për policinë të jetë shkruar më parë në zyrë dhe e redaktuar nga Zyra Ligjore dhe Drejtori.

Hapi 3: Dorëzoni ankesë te organizatat e përshtatshme të mbikëqyrjes së mediacw, këshillit të mediave të shkruara ose këshillit të pavarur të medias, nëse sulmi përfshin raportime shpifëse të mediave, postime në Facebook etj, të cilat ju vendosin ju në rrezik ose shkatërrojnë reputacionin tuaj si gazetar në Këshillin e Medias dhe/ose Autoritetet Rregullatore të Medias. Për këtë hap, keni parasysh që:

- a) Vendimi i këtyre institucioneve do të përdoret në gjykatë dhe nga organizatat e tjera ndërkombëtare, që do të punojnë në ndihmë të gazetarëve.

- b) Tregoni kujdes që ta dorëzoni ankesën brenda afateve të caktuara nga çdo institucion.
- c) Ankesat duhet të jenë shkruar më parë në zyrë, të firmosura dhe të vulosura.
- d) Staf i I/KS duhet të sigurojë që institucionet, këshilli i medias ose institucioni rregullator të lëshojnë një kopje të protokoluara të ankesës dhe ta marrin atë me vete, për ta arkivuar në zyrë.
- e) Asnjë organizatë ndërkombëtare e medias nuk do ta marrë seriozisht një gazetar të sulmuar, nëse ata nuk i shterin të gjitha mjetet juridike lokale në dispozicion, të tilla si këshillat e medias, institucionet rregullatore/ organizatat mbikëqyrëse, policinë, gjykatat, etj..

Hapi 4: Paraqitni një kërkesë te medium që ju ka sulmuar për të tërhequr artikullin dhe nëse ata nuk e bëjnë këtë - kontrolloni nëse mund të paraqisni një kërkesë për urdhër për mbrojtje të përkohshme nga gjykata. Nëse artikulli është në internet, dorëzoni kërkesë në gjykatën e shkallës së parë për një urdhër për mbrojtje të përkohshme, i cili do t'i detyronte ata të hiqnin artikullin/materialin nëse aprovohet kërkesa.

Hapi 5: Paraqitni padi për shpifje kundër gazetës që ka sulmuar I/KS/gazetarët e I/KS. Pas raportimit të çështjes në polici, paraqitni një padi për shpifje në gjykatën përkatëse. Nëse këshilli i medias merr një vendim përpara se të dorëzohet padia, bashkëngjisni vendimin e tyre. Nëse jo, vendimi mund të dorëzohet në gjykatë si dokument shtesë në një datë të mëvonshme. Tregoni kujdes që të paraqisni padinë brenda afatit të caktuar nga gjykata respektive.

Hapi 6: Shkruani një letër publike për aktorët e interesuar dhe financuesit dhe informojini ata mbi fushatën kundër I/KS përmes organizatës lokale ose përmes bordit të I/KS. Letra, e cila përshkruan se çfarë ka ndodhur dhe bën thirrje për reagim, duhet të dërgohet në adresën e të gjitha organizatave lokale dhe ndërkombëtare, që merren me lirinë e mediave. Më poshtë është një listë e institucioneve të rëndësishme që duhen kontaktuar menjëherë pas fillimit të fushatës:

- a) Komisioni Europian (Zyra në vendin përkatës dhe në Bruksel);
- b) Ambasadat e përshtatshme që punojnë për lirinë e shprehjes dhe ato-ambasadorët e të cilëve kanë treguar mbështetje për I/KS-in dhe punën e tij, të tilla si Ambasada e Zvicrës, Ambasada e Holandës, Ambasada e Gjermanisë, Ambasada Britanike dhe Ambasada Amerikane;
- c) SEEMO;
- d) Freedom House;
- e) Article 19;
- f) Përfaqësuesit e OSBE-së për Lirinë e Medias;
- g) Komisioneri i Lartë i OKB-së për të drejtat e njeriut;
- h) Reporterët pa Kufinj, Indeksi i Censurimit;
- i) Iniciativa për Mbrojtje Ligjore të Medias;
- j) Iniciativa Rinore për Të Drejtat e Njeriut.

Hapi 7: Ndiqeni çështjen me këto institucione, realizoni takime joformale me ta dhe pyetini se çfarë ka ndodhur prej kohës së dërgimit të letrës. Sigurohuni gjithashtu që ta ndiqni çështjen në përgjithësi përmes dërgimit të kërkesave për informacion te të gjitha institucionet e përmendura më sipër.

Këshilla shtesë:

- Kujdesuni që t'i dorëzoni dokumentet brenda afateve.
- Përktheni raportet e policisë dhe ankesat në Anglisht dhe dërgojini ato në adresat e organizatave ndërkombëtare, për të treguar që ju po ndiqni të gjithë mekanizmat juridikë në dispozicion.
- Ruani nga një kopje (në letër dhe formë elektronike) të çdo dokumenti, të cilët do t'ju duhen për në gjykatë.
- Nëse gazetarët janë kërcënuar dhe si rezultat nuk mund të punojnë, departamenti i burimeve njerëzore duhet të lëshojë një vendim ku thuhet se personi nuk është duke punuar për shkak të kërcënimeve. Kjo do të përdoret në gjykatë.
- Nëse keni marrë kërcënimet përmes internetit ose në çfarëdo lloj formati, raportojini ato në stacionet e policisë dhe ruajeni nga një kopje (në letër dhe formë elektronike) si provë/dëshmi të mundshme për gjykatë.

Drejtori duhet të ruajë të dhënat e të gjitha incidenteve të këtij lloji si dhe rezultatet në arkivën zyresë I/KS.

ZGJEDHJET

Raportimi i balancuar i zgjedhjeve

I/KS nuk duhet të bëjë mbulim të panevojshëm - ose të anojë përmes mbulimit në favor të një partie politike në çfarëdo kohe, por gjatë periudhës elektorale kjo është veçanërisht e rëndësishme. I/KS është një media e pavarur dhe nuk duhet të shfaqë mbështetje ose të kritikojë apo të vendosë nën shënjestër padrejtësisht partitë politike.

Gjatë kohës së zgjedhjeve, I/KS do të ndajë me partitë relevante politike rregullat dhe kushtet e pjesëmarrjes në programe televizive, shpërndarjen e kohës së transmetimit dhe detaje të tjera që do të sigurojnë prezencën në kuadër të prodhimeve të I/KS. Redaktorët përgjegjës janë përgjegjës për të siguruar që raportimi është i drejtë dhe nuk favorizon apo padrejtësisht përjashton parti të caktuara politike. Kryetarëve të partive kryesore u duhet dhënë mbulim të barabartë gjatë zgjedhjeve, ndërsa redaktorët përgjegjës e mbajnë balancën e duhur në raportimin gjatë periudhës së fushatës.

Raportimi faktual i zgjedhjeve karshi komenteve dhe opinioneve

Ndërkohë që gazetarët mund të komentojnë në editoriale ose artikuj, kujdesuni që të mos kompromentoni paanshmërinë gjatë mbulimit të zgjedhjeve. Publikimi i opinionit të një eksperti mbi mënyrën se si një parti politike po e bën fushatën është shumë ndryshe nga ndarja e mendimit tuaj mbi vetë partinë. Si rregull, gazetarët duhet ta kufizojnë dhënien e opinioneve tek "opinionit i ekspertit" në kategorinë e komenteve që masin miratimin e publikut, duke shmangur perceptimin si i njëanshëm apo me interes të veçantë.

Lajmet apo çdo lloj raporti faktual nuk duhet asnjëherë të përmbajë asnjë opinion personal të gazetarit apo redaktorit.

Zgjedhjet dhe sondazhet e votuesve

Gazetarët duhet të deklarojnë se cila organizatë e ka kryer sondazhin(et), duke përfshirë saktësisht pyetjet që u janë bërë pjesëmarrësve, dhe të bëjnë të qarta datat gjatë të cilave u kryen sondazhet, kur i përdorin ato për të matur mbështetjen e votuesve për kandidatët, etj.. Kur më shumë se një sondazh nxjerrë rezultate të ndryshme ose madje kontradiktore, përfshijini ato por sigurohuni që ato mund të krahasohen ndershmërisht apo të listohen më vete, nëse sondazhet mbulojnë tema të ndryshme.

I/KS pret që gazetarët dhe redaktorët përgjegjës të vëzhgojnë zgjedhjet të nihen me ligjet që rregullojnë raportimin e zgjedhjeve dhe sondazhet e votuesve, përfshirë rastet kur sondazhet opinionmbledhëse nuk mund të publikohen në ditën e zgjedhjeve, derisa kutitë e votimit të jenë mbyllur (exit polls).

Sondazhet dhe anketimet (në përgjithësi)

Përfshini gjithmonë informacionet mbi mostrën nëse shkruani artikull/reportazh të bazuar në një sondazh ose anketim - mos e përshkruani një raport ose një studim si sondazh/anketim nëse nuk është apo nuk përfshin pyetësorët. Sqaroni se kush e ka porositur sondazhin, kur e realizoi atë, sa njerëz morën pjesë dhe nëse është përfaqësues - pasqyruar i një demografie të caktuar. Nëse pjesëmarrësit u kontrolluan nga anketuesit apo nëse ata janë anonimë dhe në internet.

Është e rëndësishme të dihet nëse rezultatet janë *treguese* apo *përfaqësuese*.

Nëse sondazhi ka një margjinë gabimi, përfshijeni atë në artikull/reportazh. Pyesni veten nëse sondazhi ia vlen për t'u bërë lajm - a ka vlera lajmi për "sondazh" mbi hotelet më të mira, apo është më shumë një mundësi për reklamë nga kushdo që e porositi sondazhin? Rrumbullakësoni shifrat dhe përqindjet kur është e përshtatshme, sigurohuni që përqindjet shkojnë deri në 100 dhe përdorni terma të tillë si *sugjeron* apo *tregon* në vend të *shfaq* ose *dëshmon*.

CITIMET

Miratimi i kopjes

I/KS nuk i dërgon artikujt/reportazhet për miratim te të intervistuarit apo kontribuuesit. Gazetarët pritet që të shënojnë me saktësi citimet që në raundin e parë, por në rrethana të jashtëzakonshme, një gazetar mund të ketë nevojë të kontrollojë citimet me një të intervistuar dhe mund ta bëjë këtë duke i dërguar ato me email. Kjo është e lejueshme, nëse i intervistuari ka këmbëngulur në miratimin e citimeve të tij/saj përpara publikimit ose nëse gazetarit i nevojitet të kontrollojë citimet për saktësi dhe sqarime. Të intervistuarit nuk marrin kurrë të drejtën për miratimin e kopjes së plotë të një artikulli/reportazheje, por vetëm për citimet e tyre në rrethana të jashtëzakonshme.

Bashkëpunëtorët e jashtëm, të cilët janë porositur të shkruajnë një artikull/reportazh të plotë, koment, blog, analizë apo ndonjë material tjetër për publikim munden dhe duhet gjithmonë të nënshkruajnë produktin final. Autori duhet gjithmonë të nënshkruajë kopjen përfundimtare për artikuj të gjatë, të tillë si analizë, blog, koment apo hulumtim.

Saktësia: Marrja e citimeve gabim është një ndër mëkatet kardinale të gazetarisë. Kurrë mos citoni gabim një të intervistuar, ngase e vendosni të gjithë reputacionin e organizatës në dyshim. Sigurohuni që të regjistroni (preferohet) ose të shkruani citimet fjalë për fjalë (verbatim) dhe t'ua lexoni ato të intervistuarve. Nëse është e nevojshme, kontrollojini ato për së dyti me email. Blloqet e shënimeve dhe regjistrimet duhet të ruhen për një minimum prej 3 vjetësh *Shihni kapitullin për ruajtjen e të dhënave*.

Pajisjet: I/KS pret që gazetarët të jenë të aftë të regjistrojnë në mënyrë të saktë citimet dhe të përdorin pajisjet e përshtatshme për ta bërë këtë, përfshirë telefonat e zgjuar, diktafonët, kamera Go-Pros dhe pajisje të tjera. Nëse janë në dyshim, gazetarët duhet të këshillohen me redaktorët përgjegjës.

Përkthimet: Nëse jeni duke përkthyer një citim nga një gjuhë tjetër në gjuhën angleze, sigurohuni që përkthimi është absolutisht i saktë dhe nuk ndryshon kuptimin e synuar të folësit. Kthehuni pas te citimi(et) origjinal, siç u është dhënë në gjuhën origjinale dhe përdorni atë variant për të siguruar saktësinë.

Burimet: Nëse përdorni citime të marra nga një media tjetër, përdorini citimet vetëm në formën origjinale të përdorur nga media prej nga është marrë citimi. Shmangni përdorimin e citimeve në variantin e "dorës së dytë" të mediave të tjera - përpiquni gjithmonë të përdorni origjinalin.

Citimet (parafrazimet) e drejtpërdrejta ose jo: Një citim jo i drejtpërdrejtë është përmbledhje e saktë e asaj që dikush ka thënë. Përdorini citimet jo të drejtpërdrejta (parafrazimet) në rastet kur citimi origjinal është shumë i gjatë ose përmban informacion që mund të shpjegohet edhe më qartësisht. Mos përzieni kurrë citimet e drejtpërdrejta me ato të tërthorta.

Kurrë mos e parafrazoni një citim dhe më pas ta prezantoni atë si citim të drejtpërdrejtë. Një citim i drejtpërdrejtë duhet të jetë saktësisht siç e ka thënë personi.

Citimet e pjesshme dhe tri-pikat përdoren për të shkurtuar citimet.

Tre-pikëshi (...) tregon se disa fjalë janë hequr nga citimi. Tri pika përdoren në rastet kur një i intervistuar përsërit vetveten ose del nga tema dhe rikthehet te subjekti kryesor. Në këto situata, largoni përsëritjet e tepërta ose çdo dalje pa lidhje me temën.

Sigurohuni që citimet të përcjellin saktësisht kuptimin e synuar origjinal të folësit.

Shtoni kontekstin ose një shpjegim: Nëse citimi origjinal nuk është i plotë ose lexuesi mund të mos e kuptojë domethënien e asaj që personi ka thënë, shtoni një shpjegim ose përdorni kllapat katrore brenda një citimi.

Gjykoni se si mund të trajtohen më mirë citimet - të drejtpërdrejta, jo të drejtpërdrejta (të parafrazuara), të shkurtuara, me një shpjegim - rast pas rasti, por sigurohuni që ato janë 100 për qind të sakta.

MEDIA SOCIALE

Media sociale – përdorimi profesional

Llogaritë zyrtare të I/KS, të cilat përdorin mediat sociale si burim për kontribuuesit ose si pjesë të kërkimit gazetaresk duhet t'u përmbahen standardit të zakonshëm të gazetarisë.

Përdorimi i llogarive “të rreme” (si pjesë e hulumtimeve të fshehta për çështje të rënda - pedofilia etj.) duhet të bëhet vetëm me miratimin e ekipit drejtues redaktorial dhe do të miratohen vetëm nëse ka çështje me interes të mjaftueshëm publik që e justifikojnë këtë.

Shumica e parimeve në vijim bazohet në udhëzuesit ekzistues të I/KS.

Parimet bazë përfshijnë:

- Identifikojeni veten si punonjës i I/KS nëse do ta bënit këtë në situatë të ngjashme jashtë internetit;
- Mos shkruani apo postoni diçka që do ta vendoste I/KS në vështirësi apo do të kompromentonte aftësinë tuaj për të bërë punën;
- Përdorni logjikën e shëndoshë, sjelluni mirë dhe jini të ndershëm;
- Merrni parasysh që jeta juaj profesionale dhe personale bashkohen në internet, pavarësisht se sa kujdes tregoni për t'i mbajtur ato të ndara;
- Edhe nëse aktivizoni mundësitë e privatësisë që përcaktojnë se kush e sheh faqen apo profilin tuaj, merrni parasysh se çdo gjë që shkruani, shkëmbeni ose merrni me një faqe të medias sociale është publike;
- Përmbahuni të shkruani ose postoni çdo gjë - përfshi fotografi ose video - të cilat mund të perceptohen se pasqyrojnë anshmëri politike, raciste, seksiste, fetare ose forma të tjera të favorizimit që mund të përdoren për të shkatërruar besueshmërinë gazetareske të I/KS.

Përdorimi i mediave sociale si mjet raportimi: Kjo vlen për llogaritë personale në media sociale, kur ato përdoren për raportim apo përdorim personal.

- Krijimi i lidhjeve është i mirë. Është e pranueshme që të dërgohen dhe pranohen kërkesa për miqësi në Facebook me burime, politikanë, njerëz të mediave nëse është e nevojshme për qëllime raportimi, t'i ndjekësh ata në Twitter (merrni në konsideratë gjithësesi se "miqësia" apo ndjekja e kontakteve profesionale mund t'i identifikojë ata publikisht si një ndër burimet tuaja);
- Informacioni i mbledhur në internet duhet të vërtetohet në mënyrë të pavarur jashtë internetit. Intervistoni burimet personalisht ose përmes telefonit për të verifikuar deklaratat dhe pretendimet e tyre.
- Sigurohuni të keni marrë pëlqimin e informuar - është shumë e lehtë që burimet të keqkuptojnë qëllimet tuaja. Është përgjegjësia juaj që t'u thoni atyre se kush jeni, çfarë po bëni dhe se kur do të publikohet/transmetohet puna juaj;
- Jini transparentë me audiencën dhe burimet;
- Ekipi redaktorial nuk duhet të përdorë pozicionin e tyre të I/KS për të mbështetur agjenda apo çështje personale.

Përdorimi i medias sociale për të promovuar artikujt/reportazhet/punën:

- **Jini të saktë** dhe mos fryni e as thjeshtëzoni;
- **Jini të qartë** – nëse keni nevojë për ndihmë për të shkruar një titull, merrni ndihmë;
- **Përfshini linkun e artikullit/reportazhës** dhe sigurohuni që ai funksionon;
- **Redaktorët e mediave sociale** janë përgjegjës për hartimin e strategjive të promovimit për çështje të cilat janë në zhvillim, artikullin/reportazhin dhe të gjithë produktin e I/KS;
- **Redaktorët dhe ekipi i produksionit online** duhet të identifikojnë artikujt që duhet të shpërndahen dhe promovohen në rrjetet sociale të I/KS;
- **Përdorni hashtagë të përshtatshëm** për të promovuar punën (#Zgjedhjet, #Protestat, etj.)
- **Kontrolloni gramatikën dhe drejtshkrimin;**
- **Menaxhoni miqtë dhe komentet e tyre** – fshini komente dhe hiqni nga lista "e miqve" njerëzit të cilët dëmtojnë reputacionin tuaj;
- **Mos postoni informacion** që do të mund të ju turpëronte ju ose redaksinë tuaj;
- **Merrni këshilla**, kur keni dyshime flisni me kolegët, redaktorin dhe/ose eprorin.

Media sociale - llogaritë personale

Ndërkohë që llogaria personale ju përket juve, duhet të peshoni: konfidencialitetin, reputacionin e I/KSt, anësinë e perceptuar, përmbajtjen fyese, etj., edhe nëse ju nuk e përdorni llogarinë personale për punë.

Publikimi është puna juaj si gazetarë dhe mënyra se si e menaxhoni llogarinë personale mund të ndikojë në reputacionin tuaj. Pritet që ju të hiqni përmbajtje që dëmtojnë I/KS (punëdhënësin tuaj) dhe e thyejnë KODIN E SJELLJES. Publikimi i opinioneve raciste, homofobike dhe seksiste shkon në kundërshtim me vlerat e I/KS dhe do t'i referohet menaxhmentit të lartë.

KOMENTET E LEXUESVE

Moderimi-para dhe pas publikimit

Gazetarët e I/KS dhe redaktorët përgjegjës të mediave sociale kërkohet që paraprakisht të moderojnë (kontrollojnë) komentet dhe përmbajtjen e prodhuar nga përdoruesit e tjerë, përpara se të publikohet në faqen e internetit nën logon e I/KS. Moderatorët duhet të sigurojnë që të gjitha seksionet interaktive në faqet e I/KSt janë hapësira të sigurta dhe mikpritëse për lexuesit, për të komentuar apo për t'u përfshirë në debate konstruktive.

Moderatorët duhet të sigurojnë që komentet nuk janë në shkelje të ligjit apo të standardeve redaktoriale. Ata duhet gjithashtu të sigurojnë që debatet mbeten të respektueshme, të sigurta dhe të përshtatshme.

Komentet e publikuara në faqet e I/KS në media sociale janë të moderuara pas publikimit dhe do të hiqen, nëse ato thyejnë standardet ose shkelin ligjet e publikimit. I/KS ka aktivizuar filtrat kundër sharjeve, kështu që komentet që përmbajnë gjuhë fyese mund të shënohen automatikisht si të bllokuara dhe si të tilla nuk publikohen. Moderatorët e I/KS nuk redaktajnë ose heqin pjesërisht komente në media sociale, kështu që ato do të fshihen nëse dështojnë të plotësojnë standardet.

Udhëzime për moderatorët

Moderatorët duhet t'u përmbahen rregullave dhe standardeve të vendosura për komentet që publikohen në faqet në internet të I/KS për t'u lexuar nga përdoruesit. *Shikoni seksionin e titulluar: Rregullat dhe standardet e faqeve të komenteve të I/KS-it (seksioni i ardhshëm).*

Të gjithë moderatorët pritet të heqin fjalët fyese para publikimit ose të refuzojnë të publikojnë një koment të tërë, nëse gjuha e përdorur është shumë ofenduese. Moderatorët duhet të gjykojnë nëse duhet hequr një term fyese ose nëse i gjithë komenti ka qëllimin të jetë ofendues dhe nuk duhet publikuar fare.

I/KS nuk do të publikojë kurrë terma të fortë, të vrazhdë dhe fyese, përfshirë ku*vë, m*t, shk****ej, go**r etj. Fjalë të tilla si *i ndyrë, dreq ose gjepura* (por JO ndyr*si) nuk duhen hequr automatikisht, por moderatorët duhet sërish të gjykojnë tonin e përgjithshëm dhe qëllimin pas komentit, përpara se të vendosin që ta publikojnë atë. Nëse moderatorët janë në dyshim, ata duhet të kërkojnë këshilla nga redaktorët përpara publikimit apo fshirjes.

Moderatorët pritet të zbatojnë rregullat dhe standardet më të fundit për komente, pasi redaktori i mediave sociale, redaktorët seniorë dhe drejtori do t'i përditësojnë ato vazhdimisht.

Rregullat dhe standardet për faqet e komenteve të I/KS

Çdo faqe e I/KS në internet duhet të publikojë rregullat dhe standardet për komunitetin e lexuesve që poston ose dërgon komente për publikim në faqet e I/KS në internet apo në platformat e mediave sociale. Ato duhet të përmbajnë si vijon:

- 1) Udhëzime se si të dorëzohen komentet;
- 2) Një shënim të qartë që shpall nëse komentet do të kontrollohen para apo pas publikimit (moderimit), ashtu si zbatohet nga platforma (faqja në internet apo media sociale);
- 3) Rregullat dhe standardet e aplikuara nga moderatorët e I/KS për komentet e lexuesve;
- 4) Udhëzime për ankesa e raporte për komentet tjera.

Para-moderimi dhe pas-moderimi

Komentet e publikuara në faqet e I/KS në media sociale janë të pas-moderuara dhe do të largohen nëse i shkelin apo thyejnë ligjet për publikim.

I/KS ka aktivizuar filtrat kundër sharjeve kështu që komentet të cilat përmbajnë gjuhë ofenduese mund të shenjzohen automatikisht si ndotje (SPAM). Moderatorët e I/KS nuk do të redaktojnë apo hjekin pjesë të komenteve në media sociale, kështu që nëse komenti dështon t'i përmbushë standardet, ai do të fshihet.

I/KS rregullisht i përditëson standardet dhe rregullat e komentimit për të siguruar që faqet e debatit dhe komentimit publik menaxhohen në mënyrë të duhur.

Rregullat dhe standardet

I/KS rezervon të drejtën e redaktimit, të heqjes së një pjese të komentit ose madje të refuzimit për publikim të të gjithë komentit, nëse ai bën ose është si në vijim:

Reklamon produkte e shërbime - kjo përfshin faqe personale, detaje mbi ngjarje bamirësie dhe/ose ngritje të fondeve, sondazhe/anketime, kompani apo faqe interneti tregtare dhe forume jashtë I/KS dhe/ose tabela të mesazheve.

Abuzime e fyerje që synojnë pengimin e mbulimit – kjo përfshin materiale naacionaliste, seksiste, raciste, homofobike, me përmbajtje të qartë seksuale dhe ndryshe ofenduese, diskriminuese dhe të dënueshme. Moderatorët nuk publikojnë komente të cilat shfaqin mallkime, gjuhë apo terma të tillë që ofendojnë apo kërcënojnë të tjerët, përpjekje për t'u hequr si të tjerët ose përpjekje për të shkaktuar probleme ose gabime teknike, të kudogjendurit e internetit (komentet qëllimisht fyese dhe provokuese të cilat nuk i shtojnë asnjë vlerë debatit) ose flakëruese (komente që kanë qëllimin të lëndojnë të tjerët).

Përmbajnë vegëza të pavend - nëse postohen vegëza, sigurohuni që përmbajtja është nga një faqe me reputacion dhe me përdorim të lirë. Moderatorët e I/KS nuk do të publikojnë komente me vegëza nga faqe të papërshtatshme dhe pa lidhje, të tilla si faqet me pagesë, faqe të paligjshme, faqe qartazi seksuale ose çdo përmbajtje tjetër të bllokueshme.

Jashtë temës – moderatorët do të publikojnë vetëm komentet që kanë lidhje me përmbajtjen e artikullit/reportazhës dhe do të pushojë së publikuari komentet që dalin jashtë temës.

Fushatë zgjedhore - moderatorët nuk do të publikojnë komente të paraqitura nga stafi elektoral zyrtar i kandidatëve që garojnë në zgjedhje, veçanërisht kur këto janë përpjekje për të shpifur apo mbështetur kandidatë të caktuar. Nëse ekipi i fushatës së kandidatit dëshiron të kontribuojë ose të vërë në pikëpyetje përmbajtjen, ata duhet të kontaktojnë me ekipin e lartë redaktorial.

Protestat/aktivistët/lobistët – I/KS rezervon të drejtën të heqë komentet e postuara nga fushatat e protestave, lobistëve ose aktivistëve nëse shihen të papërshtatshme për publikim në faqet e debateve.

Shpifjet – I/KS është ofruer i përgjegjshëm i lajmeve dhe nuk do të publikojë materiale që përfshijnë akuza të pajustificuara ose të paprovuara, të cilat dëmtojnë reputacionin e një personi apo një kompanie.

Shkelja e kufizimeve të raportimit nga gjykatat – moderatorët duhet të sigurojnë që i gjithë materiali i publikuar, përfshirë edhe komentet e lexuesve, nuk bien ndesh me kufizimet e

raportimit të vendosura nga një gjyqtar për raste specifike apo të përgjithshme. Këto kufizime ndryshojnë nga rasti në rast, por mund të përfshijnë identifikimin e të pandehurve, kallëxuesve, dëshmitarëve, fëmijëve dhe të dhëna të tjera të rastit.

Shkelja e ligjeve të së drejtës së autorit - moderatorët nuk do të publikojnë komente që përmbajnë materiale të cilat mund të shkelin të drejtën e autorit.

Përmbajnë informata personale – moderatorët nuk do të publikojnë komente të cilat përmbajnë informacione personale të përdoruesit apo të personave të tjerë. Informacionet personale përfshijnë adresat, numrat e telefonit ose çdo lloj informacioni tjetër që mund ta vendosë dikë në rrezik.

Toni i papërshtatshëm – lexuesit që komentojnë, të cilat përmbajnë vëzhgime sarkastike ose ironike duhet të kontrollohen në mënyrë që kuptimi i tyre të mos të keqinterpretohet nga lexuesit tjerë dhe nëse toni i përdorur është i përshtatshëm për subjektin. Moderatorët mund të mos publikojnë ose të fshijnë komentet, nëse ka ndonjë dyshim për kuptimin apo tonin e përdorur.

Citimi i komenteve tjera – lexuesit duhet të tregohen të kujdesshëm kur citojnë komentet e lexuesve tjerë. Nëse lexuesit citojnë një koment që është fshirë nga moderatori për shkak se nuk ka përmbushur standardet e komentimit, ky koment gjithashtu do të fshihet.

Qartësia në gjuhë – moderatorët bëjnë çdo përpjekje për të publikuar komentet, duke përfshirë edhe rregullime shumë të vogla të drejtshkrimit e gramatikës kur është absolutisht e nevojshme. Megjithatë, moderatorët nuk do të rrezikojnë padashur të ndryshojnë kuptimin e komenteve, të cilat nuk kuptohen në formën që ato janë dorëzuar. Në këto raste, komentit nuk do të publikohet.

Limiti 200 fjalë – I/KS angazhohet që të sigurojë që debatet janë të gjalla dhe të kënaqshme për të gjithë ata që marrin pjesë. Kjo nënkupton publikimin e shpejtë, për t'i aktualitetin e komenteve. Për këtë qëllim, moderatorët do të marrin në konsideratë për të publikuar vetëm komentet që nuk i kalojnë 200 fjalë.

Si të ankohet ndaj komenteve të lexuesve

Lexuesit mund të paraqesin ankesa mbi moderimin ose për çdo koment që ata e konsiderojnë ofendues ose të papërshtatshëm në I/KS përmes emailit: info@kallxo.com ose duke e dorëzuar ankesën e tyre si një tjetër koment. Ky i fundit nuk do të publikohet, por do të lexohet nga moderatorët.

LIGJI PËR MEDIA / ÇËSHTJET LIGJORE

Seksioni në vijim mbi ligjin e mediave dhe çështje ligjore nuk zëvendëson këshillat ligjore. Është thjesht një përmbledhje e disa pikave kyçe, që gazetarët dhe redaktorët duhet të kenë parasysh përpara publikimit kur raportojnë. Redaktorët përgjegjës pritet të referojnë materialet te kryeredaktori apo drejtori nëse kanë dyshime, pasi ata janë përgjegjës për të përcaktuar nëse duhen kërkuar këshilla ligjore nga juristët e I/KS.

PËRDORIMI I AVOKATËVE

Zyra ligjore e I/KS do të miratojë të gjitha publikimet dhe transmetimet. Për çdo përmbajtje që konsiderohet ligjërish e vështirë, drejtorit i kërkohet të marrë këshilla nga një jurist i aprovuar nga I/KS përpara publikimit dhe/ose transmetimit. Kjo është një procedurë standarde e shumicës së organizatave mediatike. Shembujt përfshijnë, por nuk kufizohen vetëm në hulumtimet komplekse që përfshijnë burime të vështira, shqetësime mbi mënyrën se si është siguruar informacioni, akuza për korrupsion të nivelit të lartë dhe akuza në lidhje me individë apo korporata me prirje të larta kontestuese, etj..

Vini re gjithashtu se edhe pse shumë redaktorë janë të prirur të gjykojnë se kur këta artikuj/reportazhe mund të bëhen shkak për padi gjyqësore, ka raste kur duhet përdorur një jurist ngase përgjegjësia për të vendosur se kur duhet konsultuar një (disa) juristë i takon drejtorit.

STANDARDET NDËRKOMBËTARE

Njerëzit dhe kompanitë mund t'i padisin organizatat mediale për dëme, me pretendimin se përmbajtja e lajmeve (TV, radio apo online, etj.) ka njetosur pa të drejtë reputacionin e tyre. Padija për shpifje është një ndër sfidat më të rënda me të cilat përballen gazetarët. Gazetarët e I/KS dhe redaktorët pritet të familjarizojnë veten me ligjet vendore për shpifje.

Drejtori duhet të jetë pjesë e procesit të hartimit të udhëzimeve mbi ligjet vendore për media -përfshirë legjislacionin për shpifjet, rregulloret e kufizimit në raportim dhe ligjet e privatësisë/mbrojtjes së të dhënave. Gazetarët pritet t'u referohen këtyre udhëzimeve, sapo ato të jenë gati.

Përkufizimi i shpifjes dhe i përgojimit: shpifja mund të shpjegohet si deklaratë e rreme në formë të shkruar apo në çfarëdo formë tjetër të përhershme (përfshirë transmetimin, teatrin etj.). Një deklaratë gojore e rreme është përgojim - një shembull mund të jetë nëse dikush publikisht akuzohet nga një shitës për vjedhje në dyqan.

Është pothuajse gjithmonë shpifëse të deklaroj se një person është gënjeshtar, i falimentuar apo në vështirësi financiare - nëse deklarata është shpifëse varet nga aftësia e publikuesit/transmetuesit për ta mbrojtur atë deklaratë (zakonisht nëse mund ta dëshmojë që është e vërtetë).

Mbrojtjet: Ka një sërë mbrojtjesh ndaj pretendimeve për shpifje si në vijim: e vërteta, opinionin i ndershëm, interesi publik (Mbrojtja Reynolds) privilegji absolut dhe privilegji i kualifikuar. Zbatimi i secilës prej tyre varet nga natyra e temës së publikuar/transmetuar. I/KS pret që gazetarët dhe redaktorët të kuptojnë përkufizimet dhe mbrojtjet ndaj veprimeve kundër shpifjes.

Çështjet e zakonshme: Ekzistojnë disa situata që shoqërojnë vazhdimisht gazetarët dhe redaktorët kur vjen puna te rreziku i padive për shpifje. Ato përfshijnë si vijon:

Një i intervistuar bën deklaratë të rreme gjatë transmetimit të drejtpërdrejt: Në këtë rast, prezantuesi dhe/ose redaktori përgjegjës duhet të veprojnë me shpejtësi për të prerë apo ndaluar deklaratën dhe të sigurohet që prezantuesi të deklarojë qartë se I/KS ose programi nuk ka asnjë provë që mbështet pretendimin e bërë nga i intervistuari.

Fotografitë shpifëse: Publikimi i fotografive të papërshtatshme ose titrave të gabuar që implikojnë ose sugjerojnë se dikush është përfshirë në veprime moralisht të dyshuara apo antiligjore. *Shikoni seksionin mbi Fotografitë për udhëzime të mëtejshme.*

Shpifja në grup: nëse dikush nuk identifikohet, por referohet si anëtar i një grupi/të gjithë anëtarët e një grupi, mund të ketë hapësirë për padi nëse grupi është mjaftueshëm i vogël.

Mosidentifikimi i plotë i individëve: gazetarët duhet të pyesin nëse mosidentifikimi i plotë i një individ mund të çojë gabimisht në identifikimin publik të një personi tjetër në vend të të duhurit.

Identifikimi i paqëllimtë: Gazetarët duhet gjithashtu të pyesin nëse ata kanë përfshirë detaje në një raport që mund t'u lejojnë lexuesve - përfshi të afërmit dhe miqtë - që të identifikojnë individë, identitetet e të cilëve nuk mund ose nuk duhet të zbulohen. Kjo është veçanërisht e rëndësishme për kontribuuesit në kushtet e anonimitetit, fëmijët dhe viktimat/viktimat e supozuara të sulmeve seksuale. *Shikoni seksionin mbi fëmijët, rastet e sulmeve seksuale dhe burimet.*

Përzjerja e opinionëve me akuza/pretendimet: Një opinion mund të publikohet zakonisht në mënyrë të sigurt, por deklaratat e diçkaje që ka ndodhur nuk është një opinion, është një pohim se ngjarja ndodhi vërtet.

Për shembull, përdorimi i citimit të një eksperti që thotë se një ligj i ri që ndalon publikimin e disa kategorive të informacionit është i njëjtë me censurën - është një opinion. Përdorimi i një citimi nga një ekspert i cili thotë se një person i identifikueshëm është duke censuruar informacionin është një akuzë. Fakti se akuza u ngrit nga i intervistuari dhe më pas u përdor në një citim të atribuar nuk e mbron gazetarin nga veprimet ligjore.

I/KS pret që gazetarët dhe redaktorët të kuptojnë plotësisht ndryshimin mes të dyjave. Nëse kanë ndonjë dyshim, të dyja palët duhet t'u drejtohen për këshilla redaktorëve përgjegjës dhe/ose drejtorit. *Shikoni Manualin e Shkrimit të Lajmeve për udhëzime të mëtejshme mbi ndryshimin mes opinionëve dhe pohimeve.*

Ripublikimi i materialit shpifës nga një media tjetër: Nuk ka asnjë mbrojtje për organizatat e mediave që ripublikojnë ose marrin fragmente nga materiale shpifëse të publikuara në faqe të tjera të internetit, gazeta, televizione, etj.. Kjo gjithashtu vlenë edhe për njoftimet shpifëse të deklaratave për media. Gazetarët dhe redaktorët duhet të gjykojnë nëse materiali është i rremë dhe të kërkojnë këshilla, nëse janë të pasigurt për t'i publikuar.

Dëshmitarët – deklaratat e nënshkruara: Është një praktikë e mirë për gazetarët e angazhuar në gazetari hulumtuese që të bindin dëshmitarët për të bërë një deklaratë të nënshkruar dhe ta datojnë atë përpara publikimit të artikullit/reportazhës. Në disa rrethana, do të ishte më mirë që ata t'i bindnim të nënshkruajnë një deklaratë të tillë. Gazetarët dhe redaktorët duhet të jenë të vetëdijshëm se në rastet e çështjeve gjyqësore, ankuesit do të përpiqen normalisht të minojnë besueshmërinë e gazetarit dhe të dëshmitarit.

RAPORTIMI NGA GJYKATAT

Kufizimet e raportimit të gjykatave lokale

Gazetarët e I/KS duhet gjithashtu të njohin nga afër standardet dhe procedurat e raportimit nga gjykatat e Kosovës.

Raportimi i arrestimeve: Gazetarët duhet të sigurohen që janë të vetëdijshëm për çdo kufizim të raportimit që lidhet me publikimin e informacioneve mbi arrestimet ose nëse njerëzit po merren në pyetje si pjesë e hetimeve - përfshirë nëse mund të japin emrat e tyre ose jo. Aty ku është ligjërisht e sigurt të publikohen emrat e të arrestuarve, personave që merren në pyetje dhe/ose të akuzuarve, gazetarët duhet të raportojnë saktësisht emrin e personit/personave të arrestuar si dhe nëse ata janë ose jo të akuzuar.

Në raste të jashtëzakonshme, I/KS mund të dojë të publikojë emrat e individëve por drejtori dhe/ose redaktori përgjegjës duhet të miratojnë emërtimin e tyre përpara publikimit/transmetimit. Nëse ata nuk janë të akuzuar, gazetarët duhet të kontrollojnë me policinë nëse ata “janë duke ndihmuar në hetimet e policisë”. Gazetarët duhet të kontaktojnë personat e arrestuar/avokatin(ët) e tyre për të marrë një përgjigje mbi arrestimin/akuzën, nëse ata i mohojnë akuzat.

Fotografimi/regjistrimi në gjykatë: Gazetarët duhet të dinë nëse mund të bëjnë fotografi, të filmojnë apo regjistrojnë në gjykatë. Ata duhet të dinë gjithashtu nëse mund të kërkojnë leje për të regjistruar seancat në audio për qëllime vetëm të saktësisë në mbajtjen e të dhënave. Ata duhet gjithashtu të dinë nëse janë të aftë të marrin telefonat mobil etj., në gjykatë.

Mesazhet, Tweetët, telefonat mobil/kompjuterat: Gazetarët duhet të dinë nëse ata mundën ose jo të dërgojnë mesazhe, të postojnë në Twitter, të përdorin telefon apo kompjuter - në mënyrë të heshtur gjatë disa apo të gjitha seancave gjyqësore. Zakonisht, gazetarët nuk lejohet që të bëjnë apo të marrin telefonata gjatë seancave gjyqësore.

Identifikimi i të miturve dhe viktimave të sulmeve seksuale: I/KS në asnjë rrethanë nuk identifikon asnjë fëmijë - të përcaktuar si nën moshë 18 vjeç – të cilët janë përfshirë në procese gjyqësore. Viktimat/viktimat e supozuara të sulmeve seksuale gëzojnë gjithashtu automatikisht anonimitetin. *Shikoni seksionin e raportimit të proceseve gjyqësore që përfshijnë të miturit dhe çështje të sulmeve seksuale/përdhunimeve.*

Dokumentet gjyqësore: gazetarët mund të citojnë në mënyrë të sigurt vetëm ato dokumente të cilat janë lexuar në një seancë të hapur gjyqësore. I/KS pret që gazetarët të kuptojnë ligjet dhe kufizimet në përdorimin e dokumenteve gjyqësore.

Emërtoni në mënyrë korrekte gjykatën: I/KS pret nga gazetarët dhe redaktorët që të identifikojnë në mënyrë të saktë gjykatën dhe të përdorin titullin e saj zyrtar dhe nëse është e nevojshme të shpjegojnë nëse gjykata është penale, civile, për të mitur, Gjykatë Supreme apo e Apelit.

Përshkrimi i saktë i akuzave: Gazetarët duhet të përshkruajnë saktë të gjitha akuzat dhe fazat e gjykimit. Kjo kupton përcaktimin nëse një individ është thjesht i ndaluar, po ndihmon autoritetet/policinë me hetimin, është marrë në pyetje, është arrestuar, akuzuar, cila është akuza(t) e saktë, është shpallur fajtor (fajtor, jo fajtor, pa kontestim).

Emërtoni të gjithë të akuzuarit/të pandehurit: Artikulli/reportazha duhet të kenë emrat e të gjithë të akuzuarve, përveç rasteve kur ka kufizime të raportimit. Gazetarët janë përgjegjës për t'i kontrolluar ato në gjykatë.

Tregoni nëse i akuzuari i mohon akuzat: Të gjitha raportet që mbulojnë akuza dhe procese gjyqësore duhet të tregojnë nëse i akuzuari i mohon akuzat. I/KS pret që gazetarët të kontaktojnë me të akuzuarit dhe/ose përfaqësuesit e tyre ligjorë nëse kërkesat për gjykim nuk janë dërguar ende në gjykatë.

Tregoni nëse gjykimi vazhdon: Kur raportohet për procese gjyqësore në vazhdim, I/KS pret që gazetarët dhe redaktorët të sigurojnë që artikulli/reportazha të përfshijë një fjali përfundimtare në të cilën theksohet se a ka përfunduar procesi gjyqësor. Kjo duhet të jetë diçka përgjatë rreshtave si: Gjykimi vazhdon.

Gjykata ndalon publikimin e identiteteve ose detajeve të tjera: I/KS pret që gazetarët të zbatojnë urdhërat e gjykatës që ndalojnë publikimin e identiteteve ose specifikave. Rastet mund të përfshijnë shantazhet, dëshmitarët e mbrojtur, dëshminë e një oficeri të policisë nën maskim, materiale të ndjeshme tregtare, sigurinë kombëtare dhe sekretet shtetërore. Është përgjegjësia e gazetarit të kontrollojë të gjitha kufizimet që zbatohen mbi rastet individuale.

Sfidimi i kufizimeve gjyqësore: I/KS pret që gazetarët të këshillohen me drejtuesit e lartë redaktorial para se të sfidojnë kufizimet e raportimit të gjykatës të vendosura nga gjyqtarët.

Dëshmia e dëshmitarit në artikull/reportazh: I/KS pret që gazetarët dhe redaktorët të kuptojnë plotësisht se çfarë kufizimesh, nëse ka ndonjë, aplikohen në publikimin e raporteve gjyqësore dëshmive/deponimeve të dëshmitarëve. Drejtori duhet të përcaktojë nëse raportet nga gjykatat duhet të hiqen nga arkivat online.

Aktgjykimet dhe vendimet: Gazetarët duhet të sigurojnë që të gjitha raportet e vendimeve dhe/ose dënimeve duhet të jenë absolutisht të sakta, përfshirë edhe rastet kur në gjyq ishte më shumë se një individ.

Apelimet: Kur gjykatat kanë vendosur në favor të ankuesve apo kanë marrë vendime fajësie, gazetarët duhet të përfshijnë nëse ata kanë për synim që të apelojnë.

Raportimi i proceseve gjyqësore që përfshijnë të mitur (nën 18 vjeç)

Viktimat fëmijë, dëshmitarë dhe të pandehur - nuk duhet asnjëherë të identifikohen në asnjë raportim. I/KS i përkufizon si fëmijë/të mitur të gjithë ata që janë nën moshën 18 vjeç.

Në raste shumë të rralla, kur të miturit janë identifikuar nga gjykatat (ndoshta sepse ata po gjykohen si të rritur në gjykatë), gazetarët duhet të këshillohen me redaktorët përgjegjës - të cilët mund ta referojnë çështjen te drejtori - për të vendosur se si do të veprohet.

Gazetarët e I/KS duhet të jenë plotësisht të vetëdijshëm për legjislacionin që lidhet me raportimin nga gjykatat dhe kufizimet që zbatohen në rastet kur fëmijët janë përfshirë në procese gjyqësore, si në gjykatën penale ashtu edhe në atë civile (për të rritur dhe/ose të mitur).

Gazetarët, redaktorët dhe drejtorët duhet t'i kushtojnë vëmendje çdo rreziku të identifikimit përmes lidhjes së detajeve. Kjo ndodhë kur identiteti i dikuj zbulohet pa dashje, si rezultat i detajeve të shumta në një ose më shumë raporte të publikuara nga një media e vetme apo nga media të ndryshme të cilat publikojnë detaje të ndryshme, por që kur bëhen bashkë, u japin lexuesve/shikuesve mundësinë që të identifikojnë viktimën/viktimat e supozuara.

Rreziku i identifikimit përmes detajeve është veçanërisht i vështirë gjatë raportimit të rasteve të incestit.

Në proceset gjyqësore që përfshijnë vdekjen e fëmijëve, viktimat dhe autori(ët) i rritur i krimi zakonisht identifikohen. Vini re, megjithatë se në disa raste, gjykata do ta ndalojë identifikimin e të dyve kur ka shqetësime që përfshijnë paragjykimin e rezultatit në procese të tjera të ngjashme apo në identifikimin e të miturve të tjerë. Gjithmonë kontrolloni me gjykatën për kufizime.

Raportimi i sulmeve seksuale dhe proceseve gjyqësore për përdhunimet

Anonimiteti automatik u jepet viktimave/viktimave të supozuara të përdhunimeve, sulmeve seksuale dhe dhunës seksuale, pavarësisht moshës, gjinisë ose nëse ata janë identifikuar më parë nga media të tjera. Vetëm shfaqja në gjykatë nuk është një bazë e mjaftueshme për identifikim.

Të miturit, të përcaktuar nga I/KS si nën moshën 18 vjeç, nuk duhet asnjëherë të identifikohen. Nën 18-vjeçarët asnjëherë nuk konsiderohen kompetentë për heqje dorë nga e drejta e anonimitetit.

Gazetarët e I/KS duhet të jenë absolutisht të qartë për rastet kur gjykata ka vendosur që viktimat/viktima e supozuar mund të identifikohet dhe të kërkojnë këshilla nga redaktorët përgjegjës dhe/ose drejtorit përpara se të publikojnë/transmetojnë çfarëdo material që identifikon viktimën/viktimën e supozuar. Keni parasysh që në disa raste redaktorët/drejtorit mundet sërish të vendosin që të mos ta emërtojnë viktimën/viktimën e supozuar.

Deri sa të pandehurit në moshë madhore janë zakonisht të emërtuar, gazetarëve të I/KS u kërkohet gjithsesi të kontrollojnë nëse ka kufizime të raportimit që janë vendosur nga gjykata në lidhje me identifikimin apo zbulimin e informacioneve të hollësishme mbi të pandehurin madhor.

Nëse ka ndonjë dyshim, gazetarët duhet të kontaktojnë gjykatën dhe redaktorin përgjegjës/drejtorin për udhëzime të mëtejshme.

Ekziston gjithashtu rreziku i identifikimit të tërthortë kur raportohet për proceset gjyqësore të përdhunimeve/sulmeve seksuale. Gazetarët pritet të vlerësojnë sakt se kur zbulimi i detajeve specifike, përfshirë profesionin e ankuesit, vendin e punës, qytetin e banimit, vendndodhjen e saktë ku pretendohet se ka ndodhur sulmi, shenja dalluese/lëndimet, ngjyra e flokëve, pamja dhe veshja nuk duhen raportuar fare.

I/KS pret që gazetarët t'i kushtojnë vëmendje të veçantë tonit të raportimit. Nuk është në asnjë rast e pranueshme që të raportohen rastet e përdhunimit/sulmeve seksuale në një mënyrë të tillë që e portretizon viktimën/viktimën e supozuar si pjesërisht apo plotësisht përgjegjëse për sulmin, ashtu siç nuk duhet supozuar edhe fajësia e të akuzuarit. Pyesni veten nëse përshkrimi i veshjes së denoncuesit, përvojës seksuale apo varësisë ndaj alkoholit është vërtetë e përshtatshme për raportimin apo është thjesht një paragjykim i mundshëm.

Si rregull, gazetarët që raportojnë mbi gjykatat duhet ta kufizojnë përmbajtjen me informacionin që i vendoset përpara gjyqtarit dhe/ose trupit gjykues.

Si me të gjitha çështjet gjyqësore, gazetarët pritet të raportojnë akuzat e sakta me përpikmëri absolute. Për rastet që janë në vazhdim, raportimet duhet të jenë koherente (të jenë publikuar në të njëjtën kohë, zakonisht brenda 24 orëve pas seancës). Një shënim që shpjegon se procesi gjyqësor është në vazhdim ose vazhdon duhet të shtohet në fund të çdo raporti. Mund të jetë aq e thjeshtë sit ë shtohet në fund të çdo artikulli/reportazhi: Gjykimi vazhdon.

Shikoni udhëzimin e intervistimit të të mbijetuarve nga përdhunimet dhe sulmet seksuale.

E DREJTA E AUTORIT, MBROJTJA E TË DHËNAVE, PRIVATËSIA

E drejta e autorit/ Pronësia intelektuale/Plagjiatura

Gazetarët nuk mund të përshtasin ose ta paraqesini si të vetin materialin e njerëzve ose kompanive të tjera - përfshirë përmbajtjen e shkruar, fotografike apo video. Zotëruesi i të drejtës së autorit duhet të prezantohet si i tillë. Edhe me kopjet e agjencive (AP, etj.) duhet të atribuoni burimin dhe ekzistojnë rregulla se sa material mund të përdorni pa pagesë - madje edhe për ripublikime. Gazetarët dhe redaktorët duhet të jenë të vetëdijshëm mbi kushtet e përdorimit të materialeve të agjencive qeveritare, etj.

I/KS nuk e toleron plagjiaturën dhe gazetarët pritet të jenë transparentë nëse materiali si citimet, deklaratat, informacion, prapavia dhe çdo material tjetër - është marrë nga një organizatë tjetër apo nga një burim medial. Dështimi i njohjes së burimeve do të trajtohet si plagjiaturë dhe mund të çojë në veprime disiplinore.

Mbrojtja e të dhënave

Ligjet e mbrojtjes së të dhënave ndikojnë te gazetarët në tre mënyra kryesore:

- 1) Nëse një gazetar përdor metoda tinëzare për t'u qasur në të dhënat personale të njerëzve, ai/ajo mund të paditet, nëse nuk ka pasur arsye të shëndoshë të interesit publik.
- 2) Institucionet - qeveria, policia etj., ndonjëherë i keqinterpretojnë ligjet për mbrojtjen e të dhënave personale kur pretendojnë se nuk mund të japin informacion për shkak se të dhënat janë të mbrojtura.
- 3) Gazetarët gjenerojnë dhe ruajnë informacione për njerëz - pamje, artikuj/reportazhe, materiale kërkimore, kështu që organizatat mediatike duhet t'i përpunojnë dhe publikojnë të dhënat në mënyrë të ligjshme.

Ruajtja e sigurt: Organizatat mediale dhe gazetarët e pavarur janë të detyruar që të ruajnë në mënyrë të sigurt të dhënat - si emrat, emailët, ditëlindjet, adresat, etj. Drejtori pritët që të vendosë rregullat për ruajtjen e tyre, përfshirë sigurinë e kompjuterit, mbylljen e zyrave e kabineteve etj.

Rrjedhja e informacioneve/paraqitja e rreme: Nëse një gazetar i mbush mendjen dikujt që të rrjedhë materiale, që në disa rrethana të caktuara mund të përballet me procedura ligjore - e njëjta gjë vlen për paraqitjen e rreme si dikush tjetër për të marrë informacione personale. Gazetarët dhe redaktorët përgjegjës pritët të kërkojnë këshilla nga drejtori nëse ka pasiguri mbi shkelje të mundshme të ligjeve që rregullojnë legjislacionin mbi sekretet zyrtare dhe procedurat e trajtimit të materialeve të rrjedhura, të hakuara apo të paraqitjes së rreme si dikush tjetër.

Drejtori duhet të informohet për situata të tilla menjëherë. Përveç kësaj, drejtori duhet t'i përfshijë këto çështje në udhëzimet që do të porositen në të ardhmen.

Sfidimi i refuzimit të institucioneve për dhënien e informacionit: I/KS pret që gazetarët të njoftojnë redaktorët përgjegjës dhe/ose drejtorin për rastet kur besohet se institucionet citojnë në mënyrë të gabuar ligjet për mbrojtjen e të dhënave personale dhe/ose privatësisë për të arsyetuar refuzimin e dhënies së informacionit. Drejtori mund të vendosë që të sfidojë menjëherë refuzimin, duke përfshirë mundësinë e ndërmarrjes së veprimeve ligjore për t'i detyruar ata që të japin informacion.

Privatësia

Drejtori është përgjegjës për vendimet ndaj legjislacionit për të drejtën e privatësisë për individë, teknikat e ligjshme të raportimit, interesin publik dhe sigurinë kombëtare. Drejtori është përgjegjës për marrjen e këshillave ligjore dhe udhëzimeve për ligjet e privatësisë - duke përfshirë edhe mënyrën se si të sfidohen urdhërat gjyqësore, në rastet kur kërkohet një gjë e tillë.

NGRITJA OSE PËRBALLJA ME VEPRIMET LIGJORE

Ballafaqimi me paditë: Procedurat e I/KS

Ndonjëherë, I/KS si organizatë ose reporterët individualisht mund të bëhen subjekte të padive. Në situata të tilla, duhen informuar menjëherë Kuvendi i I/KS.

Angazhohet menjëherë një specialist të përfaqësimit ligjor duke përfshirë edhe rastet e kontribuuesve jashtë stafit, si bursistët, etj..

Refuzohet lëshimi i ndonjë dokumenti, komenti të detajuar ose informacioni në lidhje me çështjen, derisa të jenë kërkuar këshilla ligjore dhe drejtori duhet të jetë i qartë rreth asaj që mund të thuhet dhe jepet në atë fazë, pa dëmtuar rastin.

Drejtori dhe kryeredaktori duhet të marrin në konsideratë nëse do të heqin - qoftë edhe përkohësisht - materialin e kontestuar, ndoshta pas marrjes së këshillimit ligjor se si kjo mundet potencialisht të ndikojë në çështjen ligjore. Vetëm drejtori ka autoritetin që të heqë artikullin/reportazhën. Çdo incident do të vlerësohet rast pas rasti.

Sigurohet kopja e ankesës dhe identifikohet natyra e saktë e saj – çfarë është kontestuar, kush është vënë në shënjestër (individualisht gazetari, I/KS apo të dy?) dhe a duhet që çështja të referohet më parë tek organizatat për mbrojtje të mediave.

Përpiloni një dosje me prova për t'u mbrojtur ndaj pretendimit/ankesës - kjo duhet bërë nga gazetari(ët) dhe redaktori i përfshirë.

Vendoset nëse gazetari mund të detyrohet t'i zbulojë burimet dhe nëse refuzimi për ta bërë këtë mund ta çojë atë drejt burgosjes.

Merret në konsideratë nëse monitoruesit ndërkombëtarë mund të ndihmojnë, ndoshta duke rritur profilin e çështjes nëse ka shqetësime për korrupsion/gjykim të padrejtë, etj..

Konsiderohet se a do të raportohet incidenti tek organizatat e tjera - duke përfshirë organizatat e të drejtave të njeriut dhe ato të gazetarëve - nëse mund të jetë e nevojshme për të ngritur fushatë ndërgjegjëse.

Nëse çështja mbrohet me sukses, por I/KS dhe/ose gazetarët individualë u shenjësuan nga deklarata dhe mbulime shpifëse në kohën e ngritjes së ankesës/çështjes, drejtori duhet të marrë në konsideratë nëse do të nisë veprime ligjore.

Drejtorët duhet të sigurojnë që 'përvoja e mësuar' të përfshihet në udhëzimet redaktoriale, pavarësisht rezultatit të çështjes. Njësoj si procedurat e ndjekjes së krizës, të parashtruara në seksionin e menaxhimit të krizave për artikujt e kontestuar, drejtori duhet të sigurojë që i gjithë dokumentacioni që lidhet me padinë është i arkivuar në zyrat e I/KS.

Nisja e veprimeve ligjore

Herë pas here, I/KS do të ndërmarrë vetë veprime ligjore kur është e përshtatshme, duke përfshirë sfidimet e mundshme ndaj kufizimeve të raportimit dhe/ose urdhërave gjyqësorë, ngritjen e padive në lidhje me kanosje/kërcënime ose për mbrojtjen e reputacionit të I/KS apo gazetarëve individual.